

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7872 E shtunë 4 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

**Kujtdo që ka ndjekur filmimet, deklaratimet dhe fotografitë në media apo në rrjetet sociale pas takimeve individuale me kancelaren e Gjermanisë ...**

Vijon në faqen 20

Nga XHEVAT MUSTAFA

**Nervozizmi i Ramës dhe Thaçit, shprehje dështimi në Samitin e Berlinit**



Opinion i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Vetëm kredia na shpëton nga rritja anemike**



“4 vjet burg për neglizhenca në trajtimin mjekësor”

## Zbulohen ndryshimet në Kodin Penal, 3 vjet burg kush bllokoi rrugët

PS ka paraqitur paketën me propozimet për ashpërsimin e rreth 17 veprave penale

Të gjithë ata që do të bllokojnë rrugët dhe do pengojnë qarkullimin normal të njerëzve dhe automjeteve, qofshin këta protestues politikë ose jo, do të përballen me sanksione të forta ligjore. Një ditë pasi kryeministri Edi Rama bëri publike nismën për ashpërsimin e dënimeve për disa vepra në Kodin Penal, janë zbardhur disa nga propozimet konkrete ...

Në faqen 3

## EMRAT/ TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, SI NDAHEN 108 MILIONE LEKE KOMPENSIMI I PRONAVE, 155 FAMILJET QË MARRIN PARATE

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë. Dokumentet që nevojiten, karta e identitetit dhe llogaria bankare aktive



(Në foto) Zonë informale

Në faqen 6-7

**AMBASADA AMERIKANE**  
**Liria e medias, SHBA: Nëse zgjidhni të vërtetën, neve do na keni në krah**

Në faqen 2

**MAZHORANCA**  
**Edi Rama ironizon opozitën në Lezhë: Mund të ofrojmë turizëm protestash**

Në faqen 5

**OPOZITA**  
**LSI-ja publikon programin elektorral, Kryemadhi: S'jemi si Rama, na besoni**

Në faqen 4

**PREMTIMI**  
**Veliqj në këshillin bashkiak: Brenda mandatit tjetër do kemi ujë 24 orë**

Në faqen 8

**PROVIMI I SHETITIT**



**Zbardhen emrat e kandidatëve që do të testohen në fushën e mjekësisë**

Në faqen 9

**BLUE TOOTH** Rrëfihen Serena dhe Ina Sinani: Emocionet dhe sfida për të kënduar në shqip

## 'Sindolls', 2 shqiptaret në "Voice of Italy"

Dafina Zeqiri ja pse s'flet me Noizyn. Fëmijet VIP, "në gjurmët e gjakut"

NGA PAMELA ALIAJ

**P**ak net më parë ato morën pjesë për herë të parë përpara një jurie italiane në një nga formatet më të njohura në vend, "The Voice of Italy". Habia dhe ajo që i mrekulloi të katërt anëtarët ishte fakti se dy vajzat kënduan këngën e Era Istrefit dhe Ledri Vulës, "Shumë pis" në një performancë të tyre unike. Këto emocione e shumë detaje të tjera binjaket Serena dhe Ina na i kanë rrëfyer për herë të parë në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" ...



Suplement

# LIRIA E MEDIAS DEKLARATAT

"Kujtesë për politikanët", studimi: Mediat në Shqipëri censurohen

Valentina Madani


Në Ditën Ndërko mbëtare të Lirisë së Shtypit, ambasada amerikane deklaroi se kjo ditë duhet të shërbejë si një kujtesë për politikanët që të bëjnë punën e tyre për të forcuar lirinë e fjalës. Në një postim në "Facebook", ambasada amerikane shprehet se kjo ditë është gjithashtu ditë reflektimi edhe për profesionistët në media mbi çështjet e lirisë së shtypit, etikës profesionale dhe integritetit. "Dita Botërore e Lirisë së Shtypit shërben si një kujtesë për qeveritë dhe politikanët që të bëjnë punën e tyre për të forcuar lirinë e fjalës. Është gjithashtu edhe një ditë reflektimi për profesionistët në media mbi çështjet e lirisë së shtypit, etikës profesionale dhe integritetit. Në të njëjtën kohë, Dita Botërore e Lirisë së Shtypit është një ditë për të mbështetur mediat dhe gazetarët që janë shënjestra të censurës, kërcënimeve dhe dhunës. Ky studim mbi profesionistët e medias, i kryer nga IDRA, nënvizon këto çështje të rëndësishme", shkruan ambasada amerikane në Tiranë.

**TAKIMI**

Ambasada e SHBA-ve prezantoi dje në një takim me gazetarët e degës Gazetarisë në Universitetin e Tiranës gjatjet e studimit "Panorama e Medias në Shqipëri". Studimi me profesionistët e medias u realizua nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA), me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri. Studimi me profesionistët e medias u realizua nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA), me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri. Ai u kërkoj gazetarëve që të sfidojnë presionet politike, duke thënë të vërtetën. "Ju sfidoj të kërkonit dhe të tregonit të vërtetën. Ju mund t'i jepni formë të ardhmes së Shqipërisë. Nëse zgjidhni të flisni të vërtetën, ne do të na keni në krah", deklaroi z. Brian Beckman. Në fjalën e tij, z. Beckman, shef i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri nënvizoi: "Shtetet e Bashkuara e vlerësojnë lirinë e shtypit si përbërës kyç të qeverisjes demokratike. Shoqëritë demokratike nuk janë të pagabueshme, por ato japin llogari dhe shkëmbimi i ideve qëndron në themel të qeverisjes që jep llogari. Media promovon debat aktiv, ofron raportim investigativ si dhe

## Liria e medias, SHBA: Nëse zgjidhni të vërtetën, ne na keni në krah

Mesazhi i ambasadës amerikane: Mbështesni gazetarët



**ALBANA VOKSHI**

"Nën qeverisjen e Ramës janë dhjetëra gazetarë të larguar nga Shqipëria, dhjetëra të tjerë të sulmuar, kërcënuar me jetë e të përndjekur. Të tjerë gazetarë të paditur e kërcënuar edhe me burg nga kryeministri vetëm pse denoncuan lidhjet e Ramës dhe qeverisë së tij me krimin e organizuar", tha ish-deputetja e PD-së.



Nje nga protestat e opozites per bllokimin e rrugeve

## Liria e medias, Meta: S'mund të kthehemi 30 vite pas për të ndjekur VOA dhe DW

Në Ditën Botërore të Lirisë së Medias, Presidenti Ilir Meta ngriti shqetësimin se shtypi në Shqipëri është më pak i lirë dhe i pavarur, ndaj kërkoj të marrin fund aktivitetet e institucioneve me regji, pa praninë e gazetarëve. Meta theksoi se shqetësimet e thella të ngritura në raportet e fundit të "Freedom House" dhe "Reportereve pa kufij", për fatin e keq vijnë në hasin në vesh të shurdhët. "Shtypi ynë sot, edhe sipas këtyre organizatave, është më pak i lirë dhe i pavarur, mediat goditen nga retorika agresive dhe kërcënuese, rastet e dhunës ndaj gazetarëve janë shpeshtuar dhe tentativat për të përdorur fondet publike për të kontrolluar lirinë e shprehjes janë alarmante", deklaroi Meta. Sipas presidentit, kjo situatë duhet të marrë fund, pasi media e lirë luan rol kyç për të garantuar llogaridhënien dhe mirëqeverisjen. Presidenti përcolli një mesazh inkurajues për gazetarët: "Ndryshimi është në dorën tuaj dhe fillon nga përhapja e informacionit të vërtetë, pa prituri me qëllim të shprehjes t'ua servirë politika apo grupet e saj klienteliste. Të dashur gazetarë që keni vendosur të mos tradhtoni profesionin e misionin tuaj, jam pranë jush dhe sakrificave që bëni për të mbrojtur dinjitetin tuaj dhe fjalën e lirë! Ju do të triumfonit, sepse shqiptarët s'mund të kthehen 30 vite pas për të ndjekur 'Zërin e Amerikës' apo 'Deutsche Welle'-n, që të kuptojnë se çfarë ndodh në atdheun e tyre".

## Akuzat, Rama: Dita e gjykimit, me votë në 2021-shin

### Basha: Gazetarët pa liri janë si një vend pa zgjedhje të lira

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, në Ditën e Lirisë së Shtypit shprehu shqetësimin për gjendjen e mediave në vend. Sipas tij, gazetarët shqiptarë janë më pak të lirë, më të pasigurt e të censuruar dhe me pak të drejta sociale dhe ekonomike. Për Bashën, gazetarët pa liri janë si një vend pa zgjedhje të lira. "Në Ditën Ndërko mbëtare të Lirisë së Shtypit, gazetarët shqiptarë janë më pak të lirë, më të pasigurt, më të censuruar; me fare pak të drejta sociale dhe ekonomike, ndërsa shumë prej pronarëve të televizioneve, gazetave, portaleve janë më të pasur me tendera, licenca dhe favore të tjera qeveritare. Gjendja e përkëqësuar e medias në Shqipëri u reflektua me rënien me 7 vende në indeksin botëror të Lirisë së Medias, në raportin e së cilës shprehet shqetësimi 'për kapjen e mediave dhe përqendrimit e tyre në duart e një grushti biznesmenësh'. Përdorimi i



medias për avancimin e interesave ekonomike dhe jo për interesin publik është problemi kryesor; që i ka ulur medias besueshmërinë tek publiku dhe ka bërë që 80% e gazetarëve të shprehën se nuk kanë besim për të ardhmen e tyre profesionale", tha z. Basha. Sipas tij, gjendja e përkëqësuar e lirisë së medias gjatë qeverisjes së Edi Ramës reflekton gjendjen e vërtetë të demokracisë në

Shqipëri. "Zgjedhje të blera, drejtësi politike, gazetarë të censuruar: Vullneti i qeverisë është vendimtar për të përcaktuar lirinë e gazetarëve, sigurinë e tyre, të drejtat sociale dhe ekonomike. Personalisht jam angazhuar që me marrjen e drejtimit të qeverisjes së vendit, do të bëj gjithçka për të forcuar lirinë e medias si shtyllë kryesore të demokracisë", deklaroi z. Basha. Pas akuzave të opozitës se gazetarët shqiptarë janë gjithnjë e më të censuruar, kryeministri Edi Rama e konsideron komeditë të zezë me "djegësit dhe rrahësit" e gazetarëve. "Ç'komedi e zymtë me djegësit, rrahësit e shantazhuesit e deridjeshëm të gazetave, gazetarëve e mediave që flasin në emër të lirisë së tyre! Po shvyr ka gjykatës për të gjithë dhe për të gjithë sa bëhen e thuhën, vjen dita e gjykimit me votë. Pa merak, nonon po s'harron 2021-shi, - u shpreh z. Rama.

shërben si forum për të shprehur pikëpamje të ndryshme, sidomos në emër të atyre që janë të marginalizuar në shoqëri". Më tej, z. Beckman u

shpreh: "Sot, në Ditën e Lirisë së Shtypit, ju sfidoj të kërkonit dhe tregonit të vërtetën. Mund t'i jepni formë të ardhmes së Shqipërisë. Nëse zgjidhni të

flisni të vërtetën, ne të na keni në krah". Në takimin e djeshëm, gazetarët shprehën të shqetësuar për presionet politike në vend. Sa i përket

## Soreca: E ardhmja e të rinjve shqiptarë në Europë

Ambasadori i Bashkimit European në Shqipëri, Luigi Soreca, në kuadër të Javës së Europës përcolli një mesazh për të rinjtë shqiptarë. Ai tha se e ardhmja e tyre është në BE. Ambasadori theksoi se gjatë Javës së Evropës 2019, të rinjtë do të jenë në zemër të integritimit të Shqipërisë në BE. "Java e Evropës 2019 është për ata. Ne duhet t'u njohim meritat të rinjve që dalin vullnetarë për të mbështetur njerëzit në nevojë, për të ruajtur natyrën, ose thjesht, që janë të përkushtuar për të ndihmuar komunitetin e tyre. Demokracia lulëzon përmes vullnetarizmit dhe altruizmit. Gjatë Javës së Evropës 2019, të rinjtë do të jenë në zemër të integritimit të Shqipërisë në BE. Le ta çlirojmë Fuqinë e Rinisë!", tha z. Soreca.

raportit mbi situatën në botë, që prej janarit të vitit 2019, 10 gazetarë janë vrarë në krye të detyrës. Në raportin e "Reportereve pa Kufij" thu-

het se 3 gazetarë janë vrarë në Afganistan, 3 në Meksikë dhe të tjerë në Gana, Honduras, Libi dhe Mbretërinë e Bashkuar.



PS ka paraqitur paketën me propozimet për ashpërsimin e rreth 17 veprave penale

# Zbulohen ndryshimet në Kodin Penal, 3 vjet burg kush bllokoi rrugët

"4 vjet burg për neglizhenca në trajtimin mjekësor"

Të gjithë ata që do të bllokojnë rrugët dhe do pengojnë qarkullimin normal të njerëzve dhe automjeteve, qofshin këta protestues politikë ose jo, do të përballen me sanksione të forta ligjore. Një ditë pasi kryeministri Edi Rama bëri publike nismën për ashpërsimin e dënimeve për disa vepra në Kodin Penal, janë zbardhur disa nga propozimet konkrete që janë paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë në emër të Grupit Parlamentar Socialistë dhe që mbajnë firmën e Taulant Ballës. Sipas këtyre ndryshimeve vepra e bllokimit të rrugëve propozohet që të dënohet me gjobë deri në 3 vjet burg. Një tjetër veprë për të cilën socialistët propozojnë ashpërsim të dënimit është edhe ajo që ka të bëjë me sigurinë ushqimore. Nisur pikërisht nga debati i ditëve të fundit mbi stimulantët e produkteve bujqësore dhe blegtorale, PS propozon që kjo veprë të dënohet nga 3 deri në 15 vite burg, kjo në varësi dëmit që ka shkaktuar. Më konkretisht propozohet që importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, pijeve, lëndëve të tjera ushqimore, barnave të rrezikshme si dhe futja në prodhim e kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtësë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë e të pijeve, në shkëlqje të kërkesave të legjislacionit të posaçëm dënohet me burgim deri në tre vjet. Por kur kjo veprë është kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose kur nga kjo veprë penale është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit ose vdekja e njeriut, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Ndërsa kur nga kjo veprë është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e disa personave, fëmijëve, grave shtatzëna dënohet me burgim nga dhjetë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet. Po ashtu në ndryshimet e propozuara nga socialistët trajtohet në mënyrë të veçantë edhe rasti mjekimori të pakujdesshëm, duke marrë shkas kjo nga disa raste të përsëritura në spitalet shqiptare, ku ka pasur humbje jetësh. Kështu, mjekimi i pakujdesshëm tashmë bëhet neglizhencë në trajtimin mjekësor dhe kur ai shkakton vdekjen e pacientit dënohet me burgim deri në 4 vite. Po ashtu në këtë kuadër trajtohet edhe dhuna apo goditja për shkak



Mbledhje e Grupit Parlamentar Socialistë

**VASILI**

"Edi Rama ua kalon edhe nazistëve, kërkon burg për mjekët! Edi Rama bën ligje si e si të fusë në burg mjekët. Edi Rama i urren mjekët, i përçmon, i stigmatizon duke bërë ligj që t'i bëjë mjekët të jetojnë në ankth e terror. Edhe nazistët të njohur për mizorinë pa kufi të tyre kishin një raport të kujdesshëm me mjekët, aq sa edhe mjaft mjekë arritën të kthehen të gjallë nga kampet e përqendrimit. Vetëm Edi Rama po lufton t'ua kalojë edhe nazistëve".

**DËNIMET E PROPOZUARA NË KODIN PENAL**

- Bllokimi i rrugëve dhe pengimi i lëvizjes së automjeteve dhe njerëzve dënohet me gjobë deri në 3 vjet burg.
- Goditja ose kanosja e punonjësit të shërbimit mjekësor dënohet me burg deri në 3 vjet.
- Kur kjo veprë penale kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën, dënohet me burg nga 3 deri në 5 vjet.
- Vepra e cenimit të sigurisë ushqimore dënohet me burg nga 3 deri në dhjetë vite.
- Vepra e cenimit të sigurisë ushqimore kur pasqellë dëmtim të rëndë të shëndetit ose vdekjen e disa personave, fëmijëve, grave shtatzëna dënohet me burgim nga 10 deri në 15 vjet.
- Neglizhenca në trajtimin mjekësor kur shkakton vdekjen e pacientit dënohet me burgim deri në 4 vite.
- Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, dënohet me burgim nga një deri në 3 vjet.
- Kur kjo veprë kryhet në mjediset sportive, më shumë se një herë, apo është kryer nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga një deri në 5 vjet.
- Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet.
- Hyrja në fushën e lojës e personave të paautorizuar ose pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet.
- Kur kjo veprë kryhet në aktivitetet sportive ndërkombëtare, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.
- Armëmbajtja pa leje dënohet me burgim nga pesë deri në shtatë vjet.
- Prishja e qetësisë publike dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 1 milion lekë.
- Kur kjo veprë kryhet në rrethana rënduese dënohet me burgim deri në 2 vjet heqje lirie.
- Organizimi i lojërave të palejuara të fatit dhe lotove sportive dënohet me burgim deri në tre vjet.
- Ndotja e ajrit dhe e tokës dhe kur nga kjo veprë ka dëmtime shëndeti deri në vdekje dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet.

të detyrës përfshi edhe zyrtarët publikë të zgjedhur, policët apo edhe mjekët. Kur ndaj funksionarit publik do ushtrohet dhunë për shkak të detyrës personi dhunues do të dënohet me burg nga 1 deri në 3 vjet heqje lirie. Ndërkohë që kur kjo veprë do të kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën, dënimi shkon nga 3 deri në 5 vjet burg. Po ashtu paketa e ndryshimeve në Kodin Penal që propozohet përfshin edhe veprën e dhunës në aktivitetet sportive. Kështu goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në mjediset sportive, më shumë se një herë, apo është kryer nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po ashtu hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, dënohen me burgim nga gjashtë muaj

deri në tre vjet. Ndërsa hyrja në fushën e lojës, gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv, nga persona të paautorizuar ose pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në aktivitetet sportive ndërkombëtare, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po ashtu në këtë paketë trajtohen edhe vepra të tjera si ajo e ndotjes së mjedisit apo ndotjes akustike, të cilat po ashtu propozohen të dënohen më ashpër.

## Manja: Ndryshimet në Kodin Penal do i votojmë me deputetët e rinj

Kryetari i Komisionit të Ligjeve, deputeti socialistë Ulsi Manja konfirmoi ashpërsimin e Kodit Penal për një sërë veprash penale që nga goditja për shkak të detyrës e deri te veprat që cenojnë sigurinë ushqimore dhe shëndetin e qytetarëve. I ftuar në rubrikën "Opinion" në "News 24" Manja tha se do të ketë ndryshime në Kodin Penal, të cilat janë hartuar nga ekspertë të ligjeve. "Do të ketë ndryshime në Kodin Penal, ashtu siç është bërë me dije më herët. Ne do të përpiqemi të bindim edhe deputetët e rinj që të votojnë pro ndryshimeve, sepse duhen 84 vota. Ndryshimet në Kodin Penal do të bëhen për të shtuar ligje dhe për të hequr disa të tjera. Do të shtohen gjithsej 17 vepra të reja penale dhe disa të tjera do të hiqen. Për shembull do të hiqet vepra penale që ka të bëjë me ga-



bimim mjekësor; ndërsa do të dënohet sigurisht neglizhenca e mjekut", - tha Manja. Ndërkohë që ai veçoi ashpërsimin e veprën penale për goditje apo kanosje për shkak të detyrës. "Sa i përket dhunës ndaj policisë, me paketën e re të ndryshimeve në Kodin Penal, kush godet punonjësin e policisë, dënohet me burg, është ajo jo në protestë. Ligji i ri parashikon se kush godet punonjësit e policisë dënohet 1 deri në 3

vjet burgim. Kjo do të thotë se burgu është i pashmangshëm. Me këtë paketë të re ligjesh, do t'iu jepet mbrojtje e veçantë punonjësve të policisë dhe të gjithë zyrtarëve të shtetit", - deklaroi Manja. Ai shtoi se kjo paketë ndryshimesh në Kodin Penal prek edhe veprën e bllokimit të rrugëve nacionale. Manja tha se personat që bllokoi rrugët rrezikojnë deri 3 vjet burg, ndërsa shtoi se masa e dënimit do të jetë në proporcion me faktin nëse bllokoi rrugë nacionale apo dytësore. Manja nënvizoi se ndryshime në ligj do të ketë edhe për lotaritë, ku dënohet ashpër lejimi në këto lojëra i lojtarëve që nuk kanë mbushur ende 18 vjeç. Gjithashtu, dënime më të ashpra parashikohen ndaj personave që kryejnë krime ndaj shëndetit dhe mjedisit, duke i cilësuar si fusha me rëndësi për jetën e njeriut.

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Kruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 30.05.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i lirisë për shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi të Z.Shërbëtarë Barjam Boçi.

- Trulli me sipërfaqe 2863 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/16, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 107 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 48'098.4 (Dyzet e tetë mijë e nëntëdhjetë e tetë pikë katër) EURO
- Trulli me sipërfaqe 2317 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/25, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 121 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 38'925.6 (Tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë pikë gjashtë) EURO
- Trulli me sipërfaqe 790 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/23, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 119 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 13'272 (Trembëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) EURO
- Trulli me sipërfaqe 780 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/20, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 111 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 13'104 (Trembëdhjetë mijë e njëqind e katër) EURO
- Trulli me sipërfaqe 1750 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/18, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 109 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 29'400 (Njëzet e nëntë mijë e katërqind) EURO

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

# ZGJEDHJET PROGRAMI

Dokumenti nga zhdukja e papunësisë, hapja e vendeve të punës, deri tek ulja e taksave

## LSI publikon programin elektorale, Kryemadhi: S'jemi si Rama, na besoni

"Shqiptarë të punësuar me rroga të mirëpaguara"

Valentina Madani

Lëvizja Socialiste për Integrim ka nisur hartimin e një program politik, ku planifikon heqjen e akcizës së naftës për fermerët si dhe hapjen e vendeve të punës. Drejtuesja e LSI, Monika Kryemadhi, deklaroi se hartimi i programit ka ardhur pas një konsultimi të gjerë të LSI me qytetarët shqiptarë. Kryemadhi shprehet se bashkë me grupin e punës po vijnë hartimin e programit që në thelb ka uljen e papunësisë, rritjen e pagave dhe mirëqenies, uljen e akcizës për fermerët dhe mbështetjen e gruas. Kryemadhi sulmon Ramën teksa deklaron se nuk do të premtojë parajsën "si ai me premtimet për 300 mijë vendet e punës dhe dëbuan nga vendi më shumë se 400 mijë të rinj dhe të reja". "Pas një konsultimi të gjerë me shqiptarët, filluam të hartojmë programin, i cili do t'u japë zgjidhje problemeve, që kanë kapur nga fyti jetën social-ekonomike të vendit. Ne si LSI nuk premtojmë parajsën, as zgjidhje të fantapolitikës, që bëhen për të rrëmbyer votat dhe pas zgjedhjeve ato hidhen në kutitë e plehrave. Ashtu siç ngelen vetëm në spote publicitare premtimet e Rilindjes për 300 mijë vendet e punës dhe dëbuan nga vendi më shumë se 400 mijë të rinj dhe të reja, burra dhe gra. Të 'shëndetësisë falas', që në fakt është shumë më e shtrenjtë se më parë. Uljes së taksave për 97% të shqiptarëve, që në fakt u kthye në mrekullinë e vetëm 4-5 oligarkëve, klientë të oborrit të Surrelit. Ne si LSI e kemi të shenjtë fjalën e dhënë. Ajo është detyrim për ne ndaj shqiptarëve. Programi ynë po hartohet për njëzetë e zakonshëm, për ata të cilët duan të ndërtojnë të ardhmen e tyre dhe të familjeve të tyre në Shqipëri. Ne si LSI duam t'i japim zgjidhje përfundimtare papunësisë dhe do e bëjmë të mundur këtë. LSI, si asnjë forcë tjetër politike shqiptare e ka në themelin e programit të saj punësimin e shqiptarëve. Shqiptarë të punësuar me rroga të mirëpaguara janë një garanci për të ardhmen e kombit dhe familjes sh-



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi

ERVIN SALIANJI

"Parlamenti nuk përfaqëson qytetarët dhe interesat e tyre! I shërben pasurimit të pak qeveritarëve dhe zhvatjes dhe gllabërimit të djersës dhe gjakut të shqiptarëve. Në 11 maj të mblihdhemi të gjithë bashkë, të tregojmë që sovraniteti është popullit!", deklaroi ish-deputeti i PD-së.

## Kriza, Idrizi: Oferta e opozitës për Ramën, zgjedhjet e parakohshme

Shpëtim Idrizi, kryetari i PDIU para Këshillit Kombëtar të partisë që drejton nuk kurseu dhe akuzat ndaj kryeministrit Edi Rama. Idrizi akuzoi se Rama e ka të lehtë të marrë të gjitha pushtetet, ndaj qytetarëve duhet t'u jepet mundësia që të kërkojnë referendume. "Ju e keni parë shumë mirë edhe programet elektorale kanë munguar, edhe debati ka mbaruar. Është mjaftuar me stigmatizimi 'ma jepni tepsinë, ma jepni timonin'. Kjo ofertë politike. Ne sot jemi republikë parlamentare dhe është e kollajshme që të marrë të gjitha pushtetet. Kërkojnë një model që i përshtatet kryesisht atyre. Dhe gjitha këto janë arsye të mjaftueshme që ne të hyjmë të shohim sistemin tonë. Ne kemi kërkuar që të krijohet mundësia që qytetarët të marrin pjesë në referendum. Për të bërë



ndryshime kushtetuese duhen 2/5 në parlamentet. Teatri Kombëtar është rasti i parë ekselent, ku qytetarët e Tiranës të bëjnë nëse e duan apo jo Teatrin", - u shpreh Idrizi. Ai përmendi se oferta e opozitës për kryeministrin Rama për kapërcimin e krizës janë zgjedhjet e parakohshme. "Opozita shqiptare e ka dhënë zgjidhjen. Zgjidhje e krizës në momente të tilla janë zgjedhjet e para-

kohshme. Të shkojmë në zgjedhjet të parakohshme me qeveri transitore, sigurisht duke mos kërkuar pushtetin në tavolinë, por edhe përballë kësaj oferte Rilindja vazhdon të jetë arrogante. Ajo jo vetëm që nuk i përgjigjet ofertës politike të opozitës, por po shohim që po mbushet Teatri i Kukullave", e kam fjalën për parlamentin e Shqipërisë", - tha Idrizi.

veten dhe të ardhmen e tyre në Shqipëri, jo të marrin rrugët e emigrimit dhe do e realizojmë me çdo kusht këtë aspiratë. Dhe kush më mirë se ekipi i vazjavës dhe djemve të LRI mund ta realizojë këtë? Ne si LSI, në qendër të vëmendjes do të kemi përkrahjen ndaj gruas, ecjen përpara të saj në shoqëri, pavarësinë e saj

ekonomike, që të mos kthehet në 'skllave' të familjes, por në nënën e respektuar nga fëmijët, gruan e denjë në kraht të burrit, vlerën e vërtetë të kombit. E kush më mirë se grupi i grave intelektuale, luftëtareve të pakompromisë që ka LSI mund ta realizojë këtë? Ne si LSI do të ndryshojmë thellësisht qasjen e deritanishme të

politikës ndaj 50% të shqiptarëve. Ata janë konsideruar si qytetarë të dorës së dytë, nga shërbëtorët qeveritarë të oligarkëve dhe krimit. Fermerët dhe blegtorët, kontribuesit e 22% të PPB së vendit do marrin mbarsht nga buxheti i shtetit kontributin e tyre në ekonominë shqiptare. Subvencionimi do të jetë për çdo



Një nga protestat e opozitës

### SHKURTE

#### PD, Shehu: Zgjedhjet e parakohshme nuk janë fundi i botës

Për ish-deputetin e PD-së, Tritan Shehu, zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja mënyrë për të dalë nga kriza dhe nuk janë fundi i botës. Shehu deklaroi në "News 24" se protestat e opozitës janë për të dhënë një mesazh të qartë përshkallëzimi për të detyruar maxhorancën për një zgjidhje. "Do detyrohen të gjithë, sepse realisht problemi duhet zgjidhur, pasi ndryshe gjërat do shkojnë keq e më keq. Nëse nuk zgjidhen problemet, kriza do thellohet. Zgjedhjet e parakohshme në një vend demokratik nuk janë fundi i botës. Fundi i botës janë krizat e mëdha që thellohen e shpërthejnë. Zgjedhjet e parakohshme janë një mënyrë për të kaluar krizat. Të hysh në një proces zgjedhje të parakohshme nuk ka asgjë të keqe. Kemi një krizë pluridimensionale, e cila kërkon një rikonfigurim. Kemi një krizë institucionale sepse nuk ke Gjykatë Kushtetuese, nuk ke parlament", theksoi z.Shehu. Ai shpjegoi dhe nocionet e qeverisë teknike dhe asaj transitore. "Qeveria teknike është një qeveri që mund të ketë mandat shumë të gjatë, që mund të ketë detyra të ndryshme sipas problemeve që janë. Kurse këtu kërkohet një qeverisje që të ketë mandat të qartë për të çuar përpara në zgjedhje të parakohshme. Mund të jetë disamujor, është i mjaftueshëm që të sigurohen ato premisa që të mos ndodhë ajo që ndodhi në zgjedhjet e kaluara", tha ai. Shehu shprehu edhe njëherë qëndrimin e opozitës se zgjedhje në 30 qershor nuk mund të ketë.

#### BDSH padit "Bindjen Demokratike", Patozi: Pas partisë fantazmë qëndron Basha

Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar ankimoj dje në Kolegjin Zgjedhor vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin në garën e 30 qershorit të partisë "Bindja Demokratike". Në padit kërkohe shfuqizimi i këtij vendimi dhe çregjistrimi i "Bindjes Demokratike", me argumentin se kjo forcë politike është regjistruar në KQZ në mënyrë të paligjshme, pa marrë më parë formë të prerë vërtetimi i gjykatës. Por koordinatori i "Bindja Demokratike" përmes një deklaratë të shpërndarë për mediat tha se pas partisë fantazmë qëndron Lulzim Basha. Sipas Patozit, Basha është angazhuar seriozisht në betejën kundër "Bindjes Demokratike" duke u përpjekur ta pengojë atë që të marrë pjesë në zgjedhje. "Ndërkohë që për të gjithë demokratët shqiptarë - vijon deklaratën Patozi - kundërshtar mbetet Edi Rama dhe qeveria e tij, për Lulzim Bashën kundërshtar është 'Bindja Demokratike', pasi me sa duket, atë e shikon si rrezik për karrigen e tij".

kokë bagëti, për çdo koshere blete, çdo dymn të mbjellë, për çdo serë të ndërtaur, direkt te fermeri duke hequr hallkat dhe burokracitë e deritanishme, ku fermerët harxhojnë më shumë kohë dhe para për aplikime, se sa përfitonin nga subvencionet. LSI do heqë akcizën e naftës për fermerët", tha zj.Kryemadhi.



**N**ga Lezha ku morri pjesë në prezantimin e kalendarit të festave lokale që do të organizohen këtë vit në kuadër të nxitjes së turizmit, kreu i qeverisë, Edi Rama ironizoi opozitën, duke theksuar se edhe ajo me protestat e saj mund të shfrytëzohet pozitivisht për të nxitur turistët e huaj që t'i ndjekin ato. Në këtë mënyrë ai theksoi se vendi ynë mund të përfshihet në listën e vendeve që mund të ofrojë edhe "turizëm protestash". "Kjo obobo-ja e madhe nuk ka ndikuar aspak tek numri i turistëve. Ne mund të bëhemi një vend, që do mund të ofrojmë edhe turizëm protestash. Duke qenë se janë protesta me orar dhe stacione të përcaktuara dhe me të gjithë atë skenografinë e përgatitur për të argëtuar njerëzit përmes ekraneve, duke iu sugjeruar edhe vizitorëve

**Kreu i qeverisë mori pjesë në prezantimin e festave lokale**

**Rama ironizon opozitën: Mund të ofrojmë turizëm protestash**



të shohin edhe një protestë, vetëm se do të numërohen si protestues dhe do i rrisin numrin artificialisht" - tha Rama. Ndërkohë që duke folur mbi turizmin në vend, Rama tha se ai ka pësuar një zhvillim të ndjeshëm, çka është reflektuar edhe në rritjen e numrit të turistëve të huaj që kanë vizituar vendin tonë në muajt e fundit duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. "Këtë vit vazhdojmë me shpresë që janë reflektuar siç duhet ato që kemi mësuar dhe njëkohësisht me dëshirën, që të kalojë mesazhi tek operatorët, tek komuniteti dhe tek sipërmarr-

rësit. Qeveria dhe ministritë duhet të jenë aty për të ndihmuar, për të shtuar dhe pasuruar kalendarin turistik. Kanë shifrat janë inkurajuese. Numri i turistëve nordikë, këtë vit rritet me 20 % dhe ai i turistëve polakë me 40 %. Këto janë shifra që vijnë nga kontrata të operatorëve. Në muajin mars patëm 10 % më shumë të huaj që kanë hyrë në Shqipëri edhe në prill pothuajse 10% më shumë", - tha Rama.

PS organizoi dje një ceremoni me rastin e 10-vjetorit të vrasjes së deputetit të saj

**Vrasja e Xhindit, Balla: Nuk e kemi harruar detyrën që na kanë lënë**

*I biri: Na mundon pyetja kush dhe pse e vrau Fatmirin?*

**BRACE: E VRAU SHTETI, SE NUK E MUNDNIN DOT**

"Dhjetë vjet më parë, një muaj para zgjedhjeve, për shkak të tyre-ai ishte i pathyeshëm. Fatmir Xhindi e vranë në portë të shtëpisë! E vrau shteti! E vranë për të pastruar territorin elektoral nga një politikan i pathyeshëm! Pak javë para zgjedhjeve, në Roskovec të rajonit më të rëndësishëm elektoral, i majtë, në Fier! Vetëm kështu mund ta thyenin, duke e vranë! Me votë kurrë! S'e mundën dot!"

**P**otë 10 vjet nga vrasja e ish-deputetit social istë Fatmir Xhindi, ende policia dhe prokuroria nuk kanë një emër të autorit dhe motivet që çuan atë në ekzekutim të zgjedhurit të Fierit. Me këtë brengë të familjarëve të tij, miq, shokë e ish-kolegë të tij në Partinë Socialiste kanë përkujtuar dje ish-deputetin e ndërjet që u vra tek hynte në oborrin e shtëpisë së tij në Roskovec. Në ceremoninë përkujtimore kanë qenë të pranishëm kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi, kreu i grupit parlamentar Taulant Balla, deputetë të maxhorancës e përfaqësues lokalë. Duke folur në këtë ceremoni, kreu i grupit parlamentar Taulant Balla deklaroi se drejtësia e re do e zbardhë vrasjen e Xhindit. "Kur kemi ardhur këtu në 3 maj 2009 gjithë kolegët e tij ne kemi qenë me krah të prerë, sepse na ishte larguar pa ditur arsyen, arsyen të cilën ende nuk e dimë edhe sot një prej njerëzve më të rëndësishëm të grupit tonë parlamentar. Sepse rëndësia nuk është kush flet më shumë në sallën e Kuvendit, por është pikërisht se kush është më i lidhur me njerëzit. Në ka një model në këto 28 vjet e kusur të ekzistencës së pluralizmit, të lidhjes së deputetit me popullin, ndër më të mirët do të mbetet gjithmonë Fatmir Xhindi", - u shpreh Balla. Ai foli dhe për ndryshime që kanë ndodhur në vend, duke nisur që nga mundësitë e krijuara për opozitën e sotme në parlament, tek ndryshimet në Roskovec e zonat përreth apo edhe drejtësia e re, duke i parë si amanetë të deputetit të ndërjet. "Kur kujtojt sot se ç'na përsëra i kemi krijuar ne në Kuvend opozitë, krahasuar me hapësirat që kishim ne në Kuvend 2005-2009 them që sigurisht një prej amaneteve të Fatmirit ne e kemi realizuar. Sot Shqipëria realisht është një demokraci funksionale.



Sot Kuvendi i Shqipërisë është realisht një hapësirë ku nuk luftojnë më siç luftonim me Fatmirin, me Gramozin, me Petron, me Çimin, me Stefanin për të marrë goftë dhe njëherë të vetme fjalën në Kuvend, drejtuesi i grupit tonë parlamentar", - tha kryetari i grupit socialist. Duke vlerësuar edhe djalin e Fatmir Xhindit, Anduel Xhindi, si një deputet korrekt, Balla tha se socialistët nuk e kanë harruar detyrën për zbardhjen e kësaj ngjarje dhe çuarjen e drejtësisë në vend. "Unë jam sot këtu për t'ju thënë që ne nuk e kemi harruar detyrën që na ka lënë pas largimi i Fatmir Xhindit, në një mënyrë ende të pasqaruar, një krim që goditi opozitën e asaj kohe vetëm 2

muaj para zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009. Por ne kurrsesi nuk ngritëm asesi dorën dhe gishtin kundër qeverisë së asaj kohe dhe as kundër institucioneve të asaj kohe, por duhet ta them se ne jemi tërësisht të keqardhur nga mosreagimi në kohë i institucioneve goftë të policisë së asaj kohe, goftë të prokurorisë së asaj kohe dhe të gjitha për ta zbardhur këtë çështje. Nuk është koha sot për të rrahur gjoksin dhe për të thënë që ne do ta zbardhim por një gjë është e sigurt, unë i bashkohem thirrjes së kolegut tim Anduel Xhindi, drejtuar të gjitha institucioneve. Drejtësia e re që po lind është amaneti tjetër që buron nga Fatmir Xhindi dhe unë jam shumë i sigurt se kjo drejtësi e re që po lind do ta zbardhë këtë çështje dhe sigurisht kushdo që guxoi të ngrinte dorë mbi deputetin e Partisë Socialiste do të marrë dënimin e merituar", - deklaroi Balla. Ndërsa Anduel Xhindi, i cili është deputet i PS-së në këtë qark, kërkoi të gjenden autorët e vrasjes së babait të tij. "U bënë 10 vjet nga ndarja nga jeta e babait tim dhe drejtësia nuk e ka thënë fjalën e saj. Na mundon pyetja kush e vrau dhe pse e vrau Fatmirin?! Iu bëj thirrje institucioneve të drejtësisë të zbardhin ngjarjen që shpirti i tij të jetë në paqe dhe ne të jemi të qetë", - tha Anduel Xhindi.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**  
Përmbartimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmburuese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurinë :  
1- "ARE", me sipërfaqe totale 261.00 m<sup>2</sup>, e ndodhur në QIF Kamzë, Rrethi Tiranë, në Zonën Kadastrale 2066 - Numri i Pasurisë: 93/462, Vol. 45, Façe, 63, në pronësi të Tajjana Man Allushi dhe Hasan Sulejman Allushi. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 1,000,000 (një milion) .LEKE  
Ankandi e pare për pasurinë e mesiperme zhvillohet me datë 15.05.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përmburuese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Mystlym Shyri, vlla nr.8/1, kt.4, Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

**SHKURTE**

**Veliaj: Luftojmë për 61 mandate, s'ka rëndësi nëse futet ose jo opozita**

**K**reu i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj deklaroi dje se në zgjedhjet e 30 qershorit do të synohet fitimi i 61 mandateve në Këshillin Bashkiak. Veliaj nënvizoi se pavarësisht nëse opozita do të hyjë ose jo në zgjedhje, kjo mazhorancë garën e ka me veten për të arritur një rezultat më të mirë dhe për të vijuar projektet transformuese për Tiranën që kanë nisur. "Nëse opozita vazhdon të refuzojë të marrin pjesë apo të sjellë një alternativë për Tiranën përveçse të bllokojë projektet, ky është vendimi i tyre. Unë e kam thënë gjithmonë, ne garën e kemi me veten tonë. Çdo vit duhet të jemi më mirë se viti që ishim dhe në mandatin tjetër do të duhet të jemi më mirë se sa mandatin që lamë pas. Në mandatin e ardhshëm jam i bindur do të bëjmë punë akoma më të mira dhe do të mirëpresim në këtë këshill bashkiak edhe pothuajse po aq antarë të rinj që besojmë do t'i bëjnë nder këtij qyteti dhe punës që është nisur këtu. Siç e thashë ne do të luftojmë për çdo mandat për të 61 mandatet. Nuk ka rëndësi futen ata ose futen parti të tjera të vogla, për ne marrja seriozizate e fushatës është fillimisht respekt ndaj votuesve", - deklaroi Veliaj.

**Inaugurimi i xhamisë më të madhe në Turqi, Meta krah Erdoganit**

**S**tambolli ka një xhami të re, nga më të mëdhatat në Turqi. Bëhet fjalë për xhaminë Camlica, e cila u inaugurua dje gjashtë vjet pasi filloi puna për ta ndërtuar atë. Për këtë qëllim Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan organizoi një ceremoni të madhe ku të ftuar ishin personalitete dhe drejtues shtetesh, si dhe përfaqësues të klerit në botë. I ftuar në këtë ceremoni ishte edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ilir Meta. Meta ka shpërndarë edhe fotot nga kjo ceremoni ku shihet të jetë krah presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, mes personaliteteve fetare. "Një vepër e rëndësishme shpirtërore, kulturore dhe arkitekturore në kryeqendrën dhe pikëtakimin e civilizimeve botërore", - shkruan Presidenti Meta.

Çelen procedurat për kompensimin e tokave të zëna nga ndërtimet pa leje

Agjencia e Trajtit të Pronave ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 155 kërkesa të paraqitura nga subjektet përfituese, pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimet informale, që përfitojnë deri më tani kompensimin / shpërblimin në vlerë, në masën 70% të shumës së përgjithshme në të holla, të miratuar me Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. Shuma në total arrin në mbi 108 milionë lekë. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e përfituesit, të cilët të hënën do të kenë në llogaritë e tyre paratë. "Procesi i shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe i shpërndarjes së fondit të kompensimit është bazuar në ligjin nr.9482,

# ATP: Lista me 155 pronarët që marrin 108 milionë lekë

## Paratë kalojnë në llogaritë e përfituesve të hënën

datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pa-

surive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, ku është përcaktuar masa e shpërblimit për secilin pronar", - thuhet në njoftimin e ATP-së.

### SHQYRTIMI

Për 155 kërkesat e mësipërme, për të cilat ka përfunduar procesi i shqyrtimit nga ana e ATP-së, ka rezultuar se dokumentacioni i tyre është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 383, datë

19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar. "155 kërkesat e miratuara përfitojnë kështu dhe parë, të dytë, të tretë,

të katërt dhe të pestë të kompensimit në të holla në një total prej 70% të vlerës totale të miratuar me VKM-të përkatëse. Fondi financiar që shpërndahet nga ATP-ja për këto 155 kërkesa është në vlerën 180 652 533,20 lekë", - thuhet në njoftimin e Agjencisë së Trajtit të Pronave. Të dhënat në lidhje me pasuritë që kompensohen dhe mbi gjeneralitetet e subjekteve përfitues jepen në listën që publikon "Gazeta Shqiptare". Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP) njofton subjektet e interesuara se vlerat përkatëse për secilin përfitues do të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë, pas përfundimit të procedurave të transferave bankare në ditët në vazhdim.

LISTA E SUBJEKTEVE PËRFITUES NGA FONDI I ALIUZINI-T ( Kësti i parë, i dytë, i tretë, i katërt dhe i pestë - në total 70% - grupi i gjashtëdhjetë e nëntë )								
Nr. rendor	Nr. kërkesë	Datë kërkesë	Përfaqësuesi me prokurë/Subjekti përfitues			Qarku	Numri i zonës	Numri i pasurisë
			Emër	Atësi	Mbiemër			
1	496-F	01.07.2013	RIDVAN	XHEVAT	DANI	SHKODER	8594	2/824
2	802-A	23.06.2015	ATLJE	XHAFERR	MUZHQAQI	ELBASAN	8526	1313/2
3	801-A	23.06.2015	MIMOZA	RUSTEM	ALIMEHMETI	TIRANE	8310	3/216
4	801-P	20.07.2016	LIRIJE	HASAN	SEFERI	TIRANE	8310	3/216
5	846-B	28.07.2016	RUZHDI	JONUZ	LLACI	TIRANE	8170	7/246
6	847-B	28.07.2016				TIRANE	8120	8/470
7	846-C	29.07.2016	LILIANA	JETON	LIKU	TIRANE	8170	7/246
8	847-C	29.07.2016				TIRANE	8120	8/470
9	1276-A	18.11.2016	PLATON	XHEVDET	MIRAKU	ELBASAN	8527	1426/3
10	2021-D	13.11.2018				ELBASAN	8527	1426/27
11	2097-E	13.11.2018				ELBASAN	8527	1426/27
12	801-Q	23.12.2016	PETRIT	HASAN	ALIMEHMETI	TIRANE	8310	3/216
13	801-R	16.02.2017	GEZIM	BEDRI	ALIMEHMETI	TIRANE	8310	3/216
14	1623-A	22.01.2018	SOKOL	XHEMAL	SHALA	DURRES	8517	69/20
15	1767-A	20.02.2018	SHKELQIM	MANE	VZHARI	DURRES	8517	43/12
16	1768-A	20.02.2018				DURRES	8517	43/12
17	1769-A	20.02.2018				DURRES	8517	43/12
18	1770-A	20.02.2018				DURRES	8517	43/12
19	1771-A	20.02.2018				DURRES	8517	43/12
20	1772-A	20.02.2018				DURRES	8517	43/12
21	1840-A	26.03.2018	SHPETIME	HAXHI	ALLUSHI	TIRANE	8230	1/93
22	727-S	10.04.2018	ILIR	JONUZ	PERNASKA	TIRANE	8250	3/242
23	1668-C	09.05.2018	DALIP	KUJTIM	ÇIZMJA	TIRANE	8190	2/199
24	1962-D	04.07.2018				TIRANE	8190	2/501
25	1896-A	09.05.2018	GRETA	BULENT	DOMI	ELBASAN	8526	1307/1
26	1891-A	09.05.2018	MUSA	SHEFQET	PENI	ELBASAN	8521	13/368
27	1907-B	16.05.2018	ELIDA	RAHMI	SHARRA	TIRANE	8120	8/912
28	1908-B	16.05.2018				TIRANE	8120	8/303
29	1840-B	01.06.2018	BESNIK	KUJTIM	YMERAJ	TIRANE	8230	1/93
30	2023-B	26.06.2018	ARDIAN	ABDURRAHMAN	TOPTANI	TIRANE	8190	7/917

31	2023-A	26.06.2018	KUJTIM	DAUT	SOKOLI	TIRANE	8190	7/917
32	2108-A	12.07.2018	ARIAN	SHEMSI	CURRI	ELBASAN	8526	2283/50
33	2128-A	18.07.2018	KUJTIM	DERVISH	BARAKAJ	VLORE	8605	20/72
34	2129-A	18.07.2018				VLORE	8605	20/72
35	2080-D	18.07.2018				VLORE	8605	16/171
36	2061-D	18.07.2018				VLORE	8605	34/11
37	2023-C	22.08.2018	RIDVAN	DAUT	SOKOLI	TIRANE	8190	7/917
38	843-L	27.08.2018	GEZIM	SIRI	JASA	TIRANE	8270	6/378
39	1440-G	21.09.2018	HYSNIJE	IBRAHIM	KUÇUKU	TIRANE	8120	4/322
40	2218-A	28.09.2018	HYSN	SHYQYRI	HYSKJA	ELBASAN	8525	27/176
41	1621-F	28.09.2018	LILIANA	YSEN	MUÇO	VLORE	8605	13/192
42	1636-D	28.09.2018				VLORE	8605	13/192
43	2174-B	25.10.2018	REZEHANA	NEHAT	KARAMETI	TIRANE	8330	1/360
44	2097-D	01.11.2018	ISUF	XHEVDET	SKILJA	ELBASAN	8527	1426/27
45	2218-C	07.11.2018	LORETA	SHYQYRI	QOSJA	ELBASAN	8525	27/176
46	2218-B	07.11.2018	ORNELA	URAN	ABDIHOXHA	ELBASAN	8525	27/176
47	2128-B	14.11.2018	FJORALBA	ENGJELL	SORRA	VLORE	8605	20/72
48	2129-B	14.11.2018				VLORE	8605	20/72
49	2080-E	14.11.2018				VLORE	8605	16/171
50	2061-E	14.11.2018				VLORE	8605	34/11
51	2049-G	14.11.2018	LAVDIE	ASTRIT	KUTELI	ELBASAN	8527	181/6
52	2221-E	14.11.2018				ELBASAN	8527	181/1
53	2097-F	23.11.2018	AIDA	URAN	VYSHKA	ELBASAN	8527	1426/27
54	2258-A	24.12.2018	HAJREDIN	RIFAT	HOXHA	TIRANE	8310	3/737
55	2269-A	26.12.2018	NURI	IBRAHIM	VORPSI	TIRANE	8120	8/462
56	2258-B	27.12.2018	GERRI	SKENDER	HOXHA	TIRANE	8310	3/737
57	2279-A	27.12.2018	NIKOLIN	VIKTOR	KUJXHIJA	SHKODER	8593	16/590
58	2023-E	28.12.2018	AIDA	BARDHYL	BESHO	TIRANE	8190	7/917
59	2023-F	28.12.2018	EDLIRA	MUHAMED	DVORANI	TIRANE	8190	7/917
60	2023-D	28.12.2018	FUAT	FADIL	TOPTANI	TIRANE	8190	7/917
61	2288-A	03.01.2019	ENEA	KUJTIM	BRAHIMAJ	ELBASAN	8527	1362/35
62	2021-E	15.01.2019	VIOLLCA	XHEVDET	RRABOSHTA	ELBASAN	8527	1426/27
63	1242-E	23.01.2019	BASHKIM	EDIP	PUSTINA	TIRANE	8270	6/363
64	2157-F	23.01.2019				TIRANE	8170	9/102

64	2157-F	23.01.2019	ERJON	HAMDI	BILALI	TIRANE	8170	9/102	106	2397-E	28.03.2019				ELBASAN	8527	1314/23
65	2159-F	23.01.2019				TIRANE	8170	9/102	107	1285-C	28.02.2019	ARIANA	NESTOR	NEPRAVISHTA	FIER	3268	2/62
66	2335-A	23.01.2019	XHULJANA	AGIM	SEIDINI	ELBASAN	8522	14/256	108	2371-A	01.03.2019	EDMOND	VIKTOR	KOKA	TIRANE	8190	11/1137
67	2336-A	23.01.2019				ELBASAN	8522	16/367	109	2372-A	01.03.2019				TIRANE	8190	11/1170
68	2128-C	23.01.2019	EDISON	RESHAT	HAXHI	VLORE	8605	20/72	110	1886-H	01.03.2019	MERJEME	HYSNI	ÇAKO	VLORE	8605	31/44
69	2129-C	23.01.2019				VLORE	8605	20/72	111	1885-I	01.03.2019				VLORE	8605	31/103
70	2080-F	23.01.2019				VLORE	8605	16/171	112	2012-H	01.03.2019	NERSELA	NURI	BELBA	TIRANE	8190	8/988
71	2061-F	23.01.2019				VLORE	8605	34/11	113	2003-H	01.03.2019				TIRANE	8190	8/990
72	2339-A	28.01.2019	AFERDITA	MUSTAFA	BEQIRI	TIRANE	8330	6/292	114	2379-A	04.03.2019	AGRON	TEKI	TELA	ELBASAN	8527	172/1
73	2342-A	30.01.2019	MIMOZA	MIT'HAT	GJONBOÇARI	VLORE	8605	18/254	115	2373-A	04.03.2019	JOLANDA	MAHMUT	VYSHKU	TIRANE	8120	9/1569
74	2343-A	30.01.2019				VLORE	8605	18/253	116	2280-F	05.03.2019	QAZIM	HYSEN	ABDIHOXHA	ELBASAN	8527	1362/6
75	2350-A	13.02.2019				VLORE	8605	18/250	117	2365-C	06.03.2019	JALLDYS	XHELADIN	MULLAJONUZI	ELBASAN	8527	1314/23
76	2012-C	31.01.2019	TIRANE	8190	8/988	118	2397-F	28.03.2019	ELBASAN	8527	1314/23						
77	2003-C	31.01.2019	FLUTURA	ZYBER	KARAJ	TIRANE	8190	8/990	119	2365-B	06.03.2019	RENATA	MEHMET	VRAPI	ELBASAN	8527	1314/23
78	2012-D	31.01.2019	QAZIM	ZYBER	BELBA	TIRANE	8190	8/988	120	2397-B	11.03.2019				ELBASAN	8527	1314/23
79	2003-D	31.01.2019				TIRANE	8190	8/990	121	2365-D	18.03.2019				ELBASAN	8527	1314/23
80	2012-E	31.01.2019	SANIJE	ZYBER	MEMIA	TIRANE	8190	8/988	122	2397-D	18.03.2019				ELBASAN	8527	1314/23
81	2003-E	31.01.2019				TIRANE	8190	8/990	123	2391-A	07.03.2019	LIDA	ANDON	KIKINO	DURRES	8518	7/109
82	1166-O	31.01.2019	TRENDAFILE	QAMIL	LEKA	TIRANE	8330	5/729	124	2392-A	08.03.2019	FROSINA	ANDON	KAVAJA	DURRES	8518	7/327
83	2012-F	04.02.2019	VJOLLCA	ZYBER	KOÇI	TIRANE	8190	8/988	125	2395-A	11.03.2019				DURRES	8518	7/329
84	2003-F	04.02.2019				TIRANE	8190	8/990	126	2397-A	11.03.2019	EMIN	MEHMET	MEHJA	ELBASAN	8527	1314/23
85	933-E	05.02.2019	MEVLUDE	HASAN	MIRAKU	ELBASAN	8527	1414/17	127	1265-T	12.03.2019	GENCI	SAMI	JUPE	VLORE	8603	12/220
86	934-E	05.02.2019				ELBASAN	8527	303/5	128	2024-E	12.03.2019	OSMAN	SULEJMAN	ARAPI	ELBASAN	8522	16/611
87	935-E	05.02.2019				ELBASAN	8527	273/1	129	1886-I	13.03.2019	SIGFRID	KARAFIL	SULSTAROVA	VLORE	8605	31/44
88	1006-E	25.02.2019				ELBASAN	8527	277/3	130	1885-J	13.03.2019				VLORE	8605	31/103
89	2280-C	11.02.2019	BEKTASH	HASAN	POJANI	ELBASAN	8527	1362/6	131	2258-C	15.03.2019	BUJAR	RIFAT	HOXHA	TIRANE	8310	3/737
90	2194-B	11.02.2019	SOFIE	LUF	RESULI	LEZHE	2180	339/139	132	2409-A	15.03.2019	JORGJI	FILIP	SKRAMI	VLORE	8605	26/6
91	2193-B	11.02.2019				LEZHE	2180	339/139	133	2379-B	15.03.2019	NESFIJE	TEKI	SELENICA	ELBASAN	8527	172/1
92	2123-J	12.02.2019	REZART	SKENDER	JASA	TIRANE	8270	6/563	134	2003-I	15.03.2019	PETRIT	ZYBER	BELBA	TIRANE	8190	8/990
93	2185-H	12.02.2019				TIRANE	8270	6/563	135	2012-I	15.03.2019				TIRANE	8190	8/988
94	1306-N	12.02.2019				TIRANE	8270	6/453	136	1846-I	15.03.2019				TIRANE	8190	8/445
95	2269-B	12.02.2019	SOKOL	RAMAZAN	TOPI	TIRANE	8120	8/462	137	1847-I	15.03.2019				TIRANE	8190	8/988
96	2077-C	15.02.2019	ARQILE	THANAS	NDINI	VLORE	8605	11/55	138	2214-C	15.03.2019	ZHANETA	SHABAN	PULAHA	KORCE	8561	9/37
97	1913-B	15.02.2019	GENC	RAMAZAN	SHKODRA	TIRANE	8170	8/222	139	2379-E	19.03.2019	ANITA	MASAR	ALIÇKA	ELBASAN	8527	172/1
98	2166-C	15.02.2019	HAXHIRE	MEHMET	PENI	ELBASAN	8522	14/199	140	2379-D	19.03.2019	FELATUN	MAZLLEM	KARAIKAJ	ELBASAN	8527	172/1
99	2280-D	15.02.2019	KUJTIM	AHMET	PAZARI	ELBASAN	8527	1362/6	141	2166-D	19.03.2019	NAZMI	RUZHDI	QORRI	ELBASAN	8522	14/199
100	2350-B	18.02.2019	FATMIR	MIT'HAT	GJONBOÇARI	VLORE	8605	18/250	142	2379-C	19.03.2019	SHEGUSHE	MASAR	KOSOVA	ELBASAN	8527	172/1
101	1011-M	26.02.2019	DIANA	SHYQYRI	MUSAKU	ELBASAN	8527	187/2	143	2411-A	19.03.2019	SHPETIM	RIZA	QOSJA	ELBASAN	8526	99/22
102	2003-G	26.02.2019	GENCI	NURI	BELBA	TIRANE	8190	8/990	144	727-T	20.03.2019	MELIHA	ESAT	MALOKU	TIRANE	8250	3/242
103	2012-G	26.02.2019	GENCI	ZYBER	BELBA	TIRANE	8190	8/988	145	2418-A	21.03.2019	IRENA	MEHMET	DARDHA	ELBASAN	8527	1376/36
104	2363-A	27.02.2019	PRANVERA	MUSTAFA	BOGDANI	ELBASAN	8527	1412/6	146	2419-A	21.03.2019				ELBASAN	8527	1374/3
105	2365-A	27.02.2019	SALI	YMER	MULLAJONUZI	ELBASAN	8527	1314/23	147	2420-A	25.03.2019	ARBEN	RESUL	IDRIZI	ELBASAN	8526	7/1/9
106	2397-E	28.03.2019				ELBASAN	8527	1314/23	148	2365-E	25.03.2019	MIRJAM	SAMI	NDINI	ELBASAN	8527	1314/23
107	1285-C	28.02.2019	ARIANA	NESTOR	NEPRAVISHTA	FIER	3268	2/62	149	2003-J	28.03.2019	AFERDITA	MUHARREM	BASHA	TIRANE	8190	8/990
108	2371-A	01.03.2019	EDMOND	VIKTOR	KOKA	TIRANE	8190	11/1137	150	2012-J	28.03.2019				TIRANE	8190	8/988
109	2372-A	01.03.2019				TIRANE	8190	11/1170	151	1846-J	28.03.2019				TIRANE	8190	8/445
110	1886-H	01.03.2019	MERJEME	HYSNI	ÇAKO	VLORE	8605	31/44	152	1847-J	28.03.2019				TIRANE	8190	8/988
111	1885-I	01.03.2019				VLORE	8605	31/103	153	2427-A	01.04.2019	ATLJE	REXHEP	PAGRIA	TIRANE	8552	1/168
112	2012-H	01.03.2019	NERSELA	NURI	BELBA	TIRANE	8190	8/988	154	2418-B	10.04.2019	BRIKENA	SEZAI	BAXHAKU	ELBASAN	8527	1376/36
113	2003-H	01.03.2019				TIRANE	8190	8/990	155	2419-B	10.04.2019				ELBASAN	8527	1374/3

## KËSHILLI BASHKIAK MBLEDHJA

Vendimet/ Nga rikonstrukcioni i konvikteve të studentëve, te furnizimi me ujë të pijshëm

Voltiza Duro

Ditën e djeshme është zhvilluar mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, por pa praninë e këshilltarëve të opozitës. Pavarësisht kësaj, kryebashkiaku Erion Veliaj ka premtuar se brenda mandatit tjetër, Tirana do të furnizohet plot 24 orë me ujë, pasi kanë nisur punimet në terren për dyfishimin e kapacitetit të përpunues të ujit në Bovillë. "Sapo ka filluar puna që nga liqeni i madh i Bovillës në mal deri në impiantin e Bovillës, ku ne filtrimin e ujit që në fakt kanë të njëjtin emër, por janë 10 km distancë. Ka filluar për herë të parë pas 50 vitesh dyfishimi i ujit që marrim nga liqeni dhe e çojmë në impiant. Duke qenë se edhe impianti vetë po dyfishohet për filtrimin, na duhet dhe prurja gjithashtu të dyfishohet. Nëse dyfishohet 'vrëma e gjilpërës', mund të dyfishohet edhe 'filli' që shkon nëpër të për ta thënë metaforikisht. Ju kujtoj se duket sikur 4 vjet ishin para 400 vjetësh, por e morëm Tiranën me 7 orë ujë në ditë, e kemi me 14 orë dhe duam, siç kemi premtuar, nga 1 janari kur filluam këto investime madhore pasi BERZH-i na besoi kredinë e ujit, deri në fund të mandatit tjetër ne të kemi shkuar nga 14 në 24 orë ujë dhe të ndihemi të gjithë krenar që ishim pjesë e një transformimi jetësor për Tiranën", tha kryetari i Bashkisë së Tiranës. Gjithashtu, ai bëri të ditur se krahas investimeve për dyfishimin e kapacitetit të Bovillës dhe filtrimit të ujit, po punohet paralelisht edhe me shtrirjen e një linje të re transmetimi deri në zonat më periferike të qytetit. "Ne gjithashtu kemi filluar me 3 lote investimi, që çon ujin direkt nga Bovilla në zonën e Astirit, Yzberishtit, Yershekut dhe Kasharit. Përfiton gjithashtu Kombinati, 'Misto Mame', Kodër Kamza dhe njësisia 11. Zona të cilat janë stërburbanizuar në vitet e fundit falë lëvizjeve të mëdha demografike dhe më vjen mirë gjithashtu që po ecim paralelisht edhe në sjelljen e ujit, edhe në filtrimin, por edhe në shpërndarjen kapilare, sidomos në zonat që e kanë vuajtur më shumë", bëri të ditur Veliaj.

**KRIJIMI I "TIRANA AGRIKULTURË"**  
Të gjithë ata që merren me bujqësi apo me blegtori në zonat rurale të kryeqytetit do të kenë një aleat më shumë për të shitur produktet e tyre. Këshilli Bashkiak

# Bashkia krijon aleatin e ri për bujqit dhe blegtorët e zonave rurale në Tiranë

*Veliaj: Synojmë nxitjen e ekonomive familjare*



Këshilli Bashkiak i Tiranës

### PIRAMIDA PËR TË RINJTË

Një tjetër investim simbol i mandatit tjetër do jetë edhe rikonstrukcioni i Piramidës dhe kthimi i saj në qendër më të madhe të inovacionit dhe teknologjisë në rajon, ku do kenë mundësi që mijëra të rinj të mësojnë kodim dhe robotikës.

### ALEATI PËR BLEGTORËT

Të gjithë ata që merren me bujqësi apo me blegtori në zonat rurale të kryeqytetit do të kenë një aleat më shumë për të shitur produktet e tyre. Këshilli Bashkiak i Tiranës vendosi krijimin e një shoqërie të re "Tirana Agrikulturë".

Në mbledhjen e djeshme të këshillit bashkiak, kryetari i bashkisë u ndal në fjalën e tij edhe te puna për plotësimin e pjesës së Paktit për Universitetin, që i përket Bashkisë së Tiranës. Ai bëri të ditur se shumica e godinave në "Qytetin Studenti" janë në përfundim të rikonstrukcionit dhe men-

### Kryebashkiaku: Së shpejti, edhe te Bujqësori

## Pakti për Universitetin, shumica e godinave në 'Qytet Studenti' drejt përfundimit

jëherë pas tyre, puna do të zhvendoset edhe në godinat e konvikteve të Universitetit Bujqësor. Ndërkohë, kryebashkiaku theksoi se ajo që do t'i vërë vulën mandatit të

ardhshëm do jetë Kampusi Universitar. "Kur të kemi mbledhjen e fundit, do t'ju bëj edhe një raport mbi propozimin final të Kampusit Universitar në 'Qytetin Stu-

identi', që bashkë me qeverinë shqiptare ne duam të jetë një nga projektet simbol të mandatit tonë të dytë, në drejtimin e Bashkisë së Tiranës", tha Veliaj.

i Tiranës vendosi krijimin e një shoqërie të re "Tirana Agrikulturë", e cila synon përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të zonave rurale nëpërmjet nxitjes së ekonomive familjare, të cilat kanë një orientim kryesisht bujqësor dhe blegtoral, të ndërthurur me agroturizëm dhe ekoturizëm. "Krijimi i shoqërisë sonë "Tirana Agrikulturë" do të sjellë disa të mira, disa risi, së pari kemi pasur një debat kohët e fundit, mbi monopolin e shitjes së ushqimeve bujqësore me shumicë në Tiranë. Ky monopol duhet thyer dhe siç them monopolin e pastrimit, duke e kthyer në një kompani publike, sot krijimi i kësaj kompanie publike, si minimum do krijojë qendra të lira të shitjes me shumicë. Si maksimum, që është ambicia jonë, do të përfshihet gjithashtu edhe në kultiv-

imin e kultivarëve të ndryshëm që mund të ketë interes ekonomia, ose mund të ketë interes eksporti. Pra duam ta kthejmë dhe në një agregator biznesi, agregator bujqësor, përveçse një qendër të shitjes me shumicë. Besoj këto ishin lajmi i mirë për gjithë Tiranën bujqësore, e cila deri dje detyrohej të shkonte e gjitha në një vend të përcaktuar nga qeveritë e kaluara. Sot ne duam ta thejmë këtë monopol. Hapi i parë është krijimi i një kompanie publike, që do të menaxhojë tregjet me shumicë të frutave primere në Tiranë dhe pastaj më tej, të hyjë edhe në programe të bujqësisë", deklaroi Veliaj. Shoqëria "Tirana Agrikulturë" sh.p.k do të ofrojë shërbime të ndryshme në fushën e bujqësisë, blegtorisë, agropërpunimit dhe gastronomisë. Gjithashtu, detyrë e kësaj shoqërie do të jetë edhe nxitja e shitjes, or-

ganizimi i panairëve, ekspozitave dhe promovimi i prodhimeve lokale si dhe veprimtari në fushën e marketingut të prodhimeve bujqësore, blegtorale, agropërpunimit dhe shpërndarja e prodhimeve dhe shërbimeve të siguruar prej saj ndaj të tretëve. Veprimtari në fushën e mbështetjes së bashkëpunimit të fermerëve, kooperativave bujqësore dhe organizmave të tjera të vendit të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me sektorët e agrokulturës, agroindustrialisë, agroturizmit, mjedisit etj. Veprimtari si administruar i tregjeve të prodhimeve bujqësore, blegtorale e të agropërpunimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përmes kësaj kompanie do të ndërmerret lidhjen e kontratave ndërmjet personave fizikë apo juridikë, publikë, sh-

menaxhimi i një strukture tregu publik me shumicë dhe pakicë të produkteve bujqësore, blegtorale, të agropërpunimit dhe të akuakulturës. Për të rritur sigurinë ushqimore për konsumatorët, kjo shoqëri do të mund të krijojë dhe administrojë strukturat laboratorike për kryerjen e analizave të prodhimeve bujqësore e blegtorale si dhe krijimin e strukturave të përshtatshme për kultivimin dhe përdorimin e fushave eksperimentale të prodhimeve bujqësore. "Tirana Agrikulturë" do të japë me qira edhe hapësira dhe ambiente personave fizikë dhe juridike, që tregtojnë prodhime dhe ofrojnë shërbime të ndryshme në fushën e bujqësisë, blegtorisë, agropërpunimit dhe gastronomisë. Gjithashtu, detyrë e kësaj shoqërie do të jetë edhe nxitja e shitjes, or-

ganizimi i panairëve, ekspozitave dhe promovimi i prodhimeve lokale si dhe veprimtari në fushën e marketingut të prodhimeve bujqësore, blegtorale, agropërpunimit dhe shpërndarja e prodhimeve dhe shërbimeve të siguruar prej saj ndaj të tretëve. Veprimtari në fushën e mbështetjes së bashkëpunimit të fermerëve, kooperativave bujqësore dhe organizmave të tjera të vendit të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me sektorët e agrokulturës, agroindustrialisë, agroturizmit, mjedisit etj. Veprimtari si administruar i tregjeve të prodhimeve bujqësore, blegtorale e të agropërpunimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përmes kësaj kompanie do të ndërmerret lidhjen e kontratave ndërmjet personave fizikë apo juridikë, publikë, sh-

terorëre e privatë vendas e të huaj, ndërkohë që për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqëria mund të hapë njësi menaxhuese, magazinuese, shërbim tregtimi.

### RIKONSTRUKTIMI I PIRAMIDËS

Një tjetër investim simbol i mandatit tjetër do të jetë edhe rikonstrukcioni i Piramidës dhe kthimi i saj në qendër më të madhe të inovacionit dhe teknologjisë në rajon, ku do kenë mundësi që mijëra të rinj të mësojnë kodim dhe robotikës. "Ne shumë shpejt do të prokurorjmë dhe besoj që një nga stollitë e mandatit tonë të ardhshëm do të jetë padyshim qendra "TUMO" në Piramidën e Tiranës, ku tashmë janë bërë bashkë jo vetëm operatorët që do të japin mësim për 5 mijë fëmijë çdo muaj në kurset kompjuterike të dizajnit, të 'software'-t, të kodimit, të realitetit virtual, të realitetit të argumentuar, të robotikës, të mekatronikës, por gjithashtu edhe shumë kompani private, përveç atyre që përmenda, që tashmë do të binjakëzohen me qendrën që shumë prej të rinjve tanë të kenë mundësi pastaj edhe të punësohen menjëherë. Kështu që besoj do të jemi të gjithë këtu këtë vërë kur do të inaugurojmë fillimin e punimeve në Piramidë për të pasur edhe aty një histori suksesi", u shpreh Veliaj.






I vetmi në kërkim për ngjarjen e rëndë është komando Meviol Bilo

# Ngjarja në ish-'Blok', lihet i lirë biznesmeni Ervis Martinaj

## Prokuroria: Të hënën apelojmë vendimin e gjykatës

Ervis Martinaj, biznesmeni i dyshuar si një nga protagonistët kryesorë të ngjarjes në ndodhur në ish-"Blok" tetorit të 2018, me një të vradë dhe dy të plagosur, la qelitë e paraburgimit me vendim të Gjykatës së Tiranës. I dyshuari u lirua kundrejt një garancie pasurore prej 5 milionë lekësh. Personazhi i shumëpërfolur në botën e krimit ishte i vetmi që mbahej në paraburgim për ngjarjen e rëndë, që u shënua mbrëmjen e 4 tetorit në një nga lokalet luksoze në zemër të Tiranës. Por, pavarësisht faktit se gjykata vendosi të favor të të dyshuarit, prokurorët e çështjes ishin kundër lirimit të tij. Institucioni i akuzës argumentoi ndër të tjera në seancë gjyqësore se Ervis Martinaj jo vetëm ishte në rolin e organizatorit të ngjarjes, por rezultoi të jetë i përfshirë edhe në vepra të tjera penale, sikurse është mbajta e një pasaportë të falsifikuar kosovare. Zyrarisht prokuroria tha se do ta apelojë vendimin e Gjykatës së Tiranës, të cilin e konsideron të padrejtë. Ervis Martinaj u arrestua menjëherë pas ngjarjes së ndodhur në lokal "Monopol", ku kishte mbër-



ritur aty me kërkesë të Ervin Matës. Fillimisht ata janë takuar miqësisht mes tyre, por papritmas në lokal ka hyrë Fabian Gaxha dhe ka nisur të debatojë verbalisht me komandon Meviol Bilo, i cili ndodhej në shoqërinë e

biznesmenit Mata. Gaxha ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të grupit të Matës dhe në këtë moment ka reaguuar Bilo, duke qëlluar në drejtim të tij. Për pasojë, ai ka mbetur i vrarë, ndërsa u plagosën Ervis

Martinaj dhe miku i tij, Elion Hato. Të gjithë personat e dyshuar në këtë histori që mbart shumë pikëpyetje janë lënë të lirë, mes tyre dhe Ervin Mata. I vetmi që vijon të jetë në kërkim është komando Meviol Bilo.

## Aksidenti rëndë në Elbasan, vdes një grua, 4 plagosen

Një e vdekur dhe katër të plagosur në një aksident të rëndë në Elbasan. Aksidenti ndodhi në aksin rrugor Peqin-Elbasan, në fshatin Gjocaj, ku dy automjete janë përplasur me njëra-tjetrën. Sipas të dhënave paraprake të policisë, pesë persona kanë marrë dëmtime dhe janë dërguar në spital, por një grua 65-vjeçare nuk ka mundur t'u mbijetojë plagëve dhe ka ndërruar jetë rrugës. Nga të plagosurit, një është në gjendje kritike, dy të tjerë janë plagosur rëndë por pa rrezik për jetën, ndërsa një tjetër më lehtë. Dy prej të plagosurve janë identifikuar si Ismail Hoxhallari dhe Gëzim Braho nga Korça. Policia, që ka shkuar tashmë në vendngjarje ka nisur edhe hetimet për të zbardhur shkaqet e aksidentit.



## Policia kufitare: Deklaroni shumë sipas ligjit

### Po kalonte 100 mijë euro për në Malin e Zi, vihet në pranga

Një person është ndaluar në doganën e Muriqanit teksa po udhëtonte drejt Malit të Zi me njëqind mijë euro të padeklaruar. Sipas të dhënave zyrtare, strukturat e degës doganore Shkodër, në bashkëpunim me strukturat e Policisë Kufitare kanë kryer kontrolle për pasagjerët në kufi, me qëllim parandalimin e trafiqeve dhe lëvizjes së vlerave monetare. Gjatë kontrolleve të kryera nga strukturat e degës doganore Shkodër në bashkëpunim me strukturat e Policisë, në Pikën e Kalimit Kufitar Muriqan, u konstatua dhe u ndalua shtetasit A.Q., i cili po transportonte një vlerë në valutë të padeklaruar prej 100.000 euro. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u bën me dije shtetasve, të cilët kalojnë në pikat kufitare të Shqipërisë për detyrimin ligjor (Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit") për deklarimin e vlerave monetare, sendeve me vlerë, apo metale dhe gurëve të çmuar, të cilat janë me vlerë më të madhe se 1.000.000 lekë.



Strukturat e degës doganore Shkodër, në bashkëpunim me strukturat e Policisë Kufitare kanë kryer kontrolle për pasagjerët në kufi, me qëllim parandalimin e trafiqeve dhe lëvizjes së vlerave monetare.

## NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e trete për pasurinë:

1- "Trrall", me sipërfaqe 250 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 85m<sup>2</sup>, e ndodhur në Blinçke, Devoll, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 183150, Vol. 20, Faqe 70, me pronesi të Vasil Fort Mueoku. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerë e 630,000 (gjashtëqind e tridhjetë mijë) LEKË

Ankandi i trete për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 23.05.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1, kt.4, Tiranë, nr.kontakti 069381883.

# KFW

KfW Entwicklungsbank, one of the world's leading bilateral development banks, is an integral part of KfW Bankengruppe. Currently we finance and guide some 1,800 projects in over 100 countries. In Albania KfW primarily supports projects in the energy sector, municipal infrastructure and sustainable economic development. KfW Entwicklungsbank works on behalf of the German Government, helping to achieve the goals set for German Development Cooperation.

For its office in Tirana, KfW Entwicklungsbank is looking for a highly qualified and motivated

## PROJECT COORDINATOR

The Coordinator's role is to provide support to the project acquisition, preparation, implementation and monitoring process in close coordination with the office's director and the respective project managers in Frankfurt, Germany. To this end, he/she will

- build up and maintain excellent contacts to project partners and clients, i. e. relevant sector ministries, local government administrations as well as state-owned enterprise,
  - help to develop new projects in line with the priority areas defined by the Government and in line with headquarters strategies,
  - screen and assess project proposals received with regard to their plausibility and feasibility,
  - prepare and support project appraisal and evaluation missions,
  - attend and minute meetings with project partners,
  - draft documents and correspondence,
  - continuously research, monitor and report on market and sector developments including relevant government sector policies as well as legislation,
  - represent KfW Entwicklungsbank vis-à-vis all relevant partner institutions (associations, donor agencies, etc.), and during important events, and
  - generally facilitate procedures and communication with partner institutions and clients and support KfW's Tirana Office in its various functions.
- The portfolio will tentatively cover the environment (energy efficiency in Public Buildings, green transport, Biodiversity and Nature Conservation) as well as TVET

## Necessary qualifications:

- University degree in Economics, Business Administration, Public Law, Engineering or related fields of study
- 3-5 years of work experience in finance or development cooperation
- strong and proven analytical skills
- computer literacy skills (MS Office)
- fluent in English (both written and spoken)
- favorably also very good knowledge of German
- excellent organizational skills and ability to manage / follow-up on complex administrative processes
- excellent communication and negotiation skills, highest level of integrity, autonomy in the day-to-day work
- proven ability to work in a team
- cooperation experience with government institutions and familiarity with public procurement and budgeting procedures would be a strong asset
- Previous experience in the areas of environment (as defined above) and/or TVET will be an asset

The position is tendered as a full-time fixed-term contract of one year with possibility of extension; application for part-time will be considered. Starting date is September 1st 2019

## Contact:

Candidates are requested to send their motivation letter (mandatory), CV and credentials as one pdf not exceeding 10 MB to the following address: career.tirana@kfw.de  
Deadline for submission of applications is **May 15th, 2019**.  
Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

PRONARET
KOMPENSIMI

Ndërtimet pa leje, marrin tapitë për truallin 1000 përfitues, sipërfaqet që legalizohen

Qeveria miraton një fond prej 105 milionë lekësh për kompensimin e 300 pronarëve, që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Në të njëjtin vendim është miratuar edhe kalimi i pronësisë për truallin mbi të cilin është ndërtuar...

Agjencia e Kadastrës, 105 milionë lekë për 300 pronarë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër

Agjencia e Kadastrës, në bashkëpunim me Ministrave të Përfundimit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Turizmit dhe Kulturës, referuar kartelave të pasurive sipas Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është 10 993,97 m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 105 224 873 lekë...

Gjirokastër, Kavajë dhe Kukës të regjistron brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekekë ligjore mbi to. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Table with columns: Nr. renditje, Emër, Atësi, Mbiemër, Leja e legalizimit (Numer, Date), Pjesa takue se në parca, Pjesa juridike (pronësia). Rows list property owners and their registration details across various municipalities.

Table with columns: QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE. Rows list property owners and their registration details across various municipalities.

Bashkia e Tiranës kryen restaurim total të apartamentit me arkitekten Terragni

# Vendimi: Si do të shndërrohet në muze shtëpia e Ismail Kadaresë në Tiranë

*Veliaj: Pas disa ditësh, hapja e këtij stacioni të ri për turistët*

Voltiza duro

Shtëpia në kryeqytet e gjeniu të letrave, Ismail Kadare, do të kthehet në muze e shumë shpejt do të hapë dyert për të gjithë qytetarët e Tiranës dhe turistët e huaj e vendës. Lidhur me mënyrën se si do të funksionojë apartamenti ku jetoi e punoi shkrimtari i madh, është diskutuar edhe ditën e djeshme në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës. Pas vendimit të këtij të fundit, Bashkia e Tiranës, në bashkëpunim me arkitekten e njohur Elisabetta Terragni ka restauruar të gjithë apartamentin për kthimin në muze të shtëpisë së shkrimtarit të madh në Rugën e Dibrës. Me vendimin e djeshëm në Këshillin Bashkiak i hapet rruga e kthimit në një muze të vendit ku Ismail Kadare shkroi disa nga kryeveprat e tij. "I shërben përveç tërheqjes së sa më shumë turistëve dhe zgjatjes së qëndrimit të tyre. Ismaili është produkti më i njohur 'Made in Albania'. Krijohet një stacion tjetër në Tiranë, jo vetëm sheshi, liqeni, Pazari i Ri, kalaja, galeria. Tani shtohet edhe

shtëpia Kadare dhe më vjen shumë mirë që disa ditë më pas do kemi mundësi që ta hapim", tha Veliaj.

**FUNKSIONI I MUZEUT**

Muzeu do të prezantojë për publikun vendës e të huaj një pjesë të historisë dhe kulturës materiale dhe shpirtërore të periudhës totalitare përmes pasqyrimit të mënyrës së jetesës së shkrimtarit. Brenda apartamentit ekspozimi ndahet në mënyrë të qartë midis studios me dokumente origjinale, objekte, libra dhe mobilie dhe pjesës tjetër të banesës, ku merren njohuri për veprën e shkrimtarit dhe përfshihet këndi i leximit dhe ai SAL (Suvenirë, Art dhe Libra). Me hapjen e një destinacioni me interes letrar e kulturor në krah të sheshit "Skënderbej", bash-



Shtëpia ku ka banuar Shkrimtari Ismail Kadare

kia synon të tërheqë tregun ndërkombëtar turistik, krijon një vlerë të shtuar për kryeqytetin, rrit numrin e turistëve si dhe edukon të

rinjtë me veprat letrare të autorit me famë ndërkombëtare. Pjesë e projektit të bashkisë është edhe shtëpia e Dritëro Agollit, që gjendet

një kat më lart në ndërtesën e famshme të para viteve 90, të njohur edhe si "pallati me kube" dhe që mbart një histori më vete.

**HAPJA E MUZEUT**

"I shërben përveç tërheqjes të sa më shumë turistëve, edhe zgjatjes së qëndrimit të tyre. Ismaili është produkti më i njohur 'Made in Albania'. Krijohet një stacion tjetër në Tiranë, jo vetëm sheshi, liqeni, Pazari i Ri, kalaja, galeria. Tani shtohet edhe shtëpia Kadare dhe më vjen shumë mirë që disa ditë më pas do kemi mundësi që dhe ta hapim", tha Veliaj.

**Fibank**

emeton me sukses obligacionin me vlerë 2 milione Euro

**Fibank emetoi obligacionin e pare, ne shumen 2 milione Euro, nepermjet nje oferte private.**

Rreth një muaj me pare Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare miratoi prospektin e paraqitur nga Fibank, ne te cilin percautohej emetimi i obligacioneve me afat 7 vjecar, ne monedhen Euro, me norme interesi fikse prej 4.5% ne vit.

"Fibank eshte banka e dyte ne Shqiperi e cila emeton obligacionet e saj. Ne kete menyre ajo ruan rolin e saj pionier ne tregun financiar shqiptar dhe vijon te kontribuojne ne zhvillimin e tregut te kapitaleve ne vend. Iniciativat e saj ne kete drejtim jane te dukshme dhe ne rritje. Jo rastesisht Fibank prej vitesh ka qene e vetmja banque depozitare per Fondet e Pensioneve dhe Investimeve" - thote Elma Lloja, Drejtore Ekzekutive ne Fibank.


Ne te njejtin kuader eshte edhe iniciativa e fundit per te qene nje prej 5 bankave Market Maker te cilat lu pergjigjen pozitivisht projektit te rendesishem te Ministrise se Financave dhe Bankes Botorore per emetimin e obligacioneve reference (benchmark) duke ndikuar ne kete menyre ne krijimin e kurbes se yield-eve te letrave me vlerë te qeverise. Ne baze te ligjit, emetimi i obligacioneve me oferte private, kufizohet ne pjesemarrjen e jo me shume se 100 investitoreve ne blerjen e tij. Kerkesa e larte e cila shoqeroi emetimin e tyre nga Fibank deshmoi per nje besim ne rritje te investitoreve shqiptare ndaj bankes emetuese, por edhe ndaj ndryshimeve qe po peson tregu i kapitaleve ne vend. Se fundmi, vec bankave, vemendje ndaj ketyre instrumentave kane treguar edhe institucione te tjera financiare jo-banka.

Emetimi i ketyre lloj instrumentave zgjeron alternativat e investimit qe ofrohen aktualisht ne tregun shqiptar. Aktualisht monedha Euro mund te investohet ne depozita kursimi me norma shume afer zeros, ne obligacione qeveritare ose ne fonde te investimeve. Nga kendveshtrimi i investitoreve, shtimi i kesaj alternative te re investimi, ofron nje shkalles me te larte diversifikimi te risqeve, duke optimizuar njekohesisht perfitueshmerine.

**Problematikat trajtohen në Samitin e I Rinor**

**Zgjedhjet vendore/ Sondazhi: Të rinjtë shqiptarë s'kanë besim te partitë**

Shqipëria mikpritit dje Samitin e I Kombëtar të të Rinjve, organizuar nga rrjeti Kombëtar i të Rinjve në Shqipëri (ANYN). Samiti pati temë qendrore të tij "Perspektivat e reja për pjesëmarrjen dhe fuqizimin e të rinjve". Gjatë Samitit u bënë publike edhe gjetjet kryesore të Anketës Kombëtare "Rinia 2019", të cilat ndihmuan ndër të tjera edhe në hartimin e Axhendës Kombëtare të Rinisë 2019-2023 dhe në raportin e dytë kombëtar "Të Rinjtë në Shqipëri 2019". Anketat kombëtare tregoi edhe njëherë faktin se janë partitë politike, ato që ngushtojnë hapësirat e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën politike. "Ky samit është një thirrje e hapur për të gjitha partitë politike në Shqipëri, që të krijojnë sa më shumë hapësira për të rinjtë, në mënyrë që të jenë ata që të vendosin për çështjet e tyre!", -tha drejtori i CRCA/ECPAT Shqipëri, Altin Hazizaj. Axhenda Kombëtare është fryt i një procesi të gjerë konsultimesh me të rinjtë dhe të rejtat në 12 qarqe të vendit,



si dhe nëpërmjet një pyetësori 'online' që kërkon të influencojë programet e partive politike në zgjedhjet e parashikuara vendore në qershor 2019, si dhe të përmirësojë politikat lokale dhe kombëtare të të rinjve në Shqipëri, duke përfshirë edhe hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë në Shqipëri pas vitit 2020. Gjithashtu, axhenda do të jetë një dokument udhëheqës për të influencuar të gjitha ligjet, buxhetin, programet dhe aktivitetet për të rinjtë në të gjithë Shqipërinë. Në këtë event të parë kombëtar, një rol tepër të rëndësishëm luajnë

ambasadorët e rinisë, të cilët vijnë nga profesione dhe fusha të ndryshme si media, shoqëria civile, arti, kultura, politika etj. Ata kanë marrë përsipër që gjatë dy viteve të ardhshme të promovojnë kauzën e rinisë kudo ku ata punojnë dhe kontribuojnë. Samiti do të organizohet çdo dy vjet. Këtë vit ai përko me Javën Rinore Evropiane 2019, organizuar nga Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Arsim, Rinë, Sport dhe Kulturë, në partneritet të ngushtë me Parlamentin Evropian.

# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 659

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Allaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 4 Maj 2019

## SERENA & INA

### "SFIDA PËR TË KËNDUAR SHQIP"



Pjesë e "Voice of Italy"/ Flasin binjaket shqiptare Sinani:  
Produksioni italian, i emocionuar që sillnim kulturën tonë në skenë

Shkak bashkëpunimi i tyre?

## DAFINA ZEQRIRI

### S'flet më me Noizyn dhe Dhurata Dorën



## FEMIJET VIP


### Në gjurmët e gjakut, zgjedhën profesionin e prindërve të famshëm



- "DO PËRFUNDOSH ME QEROSIN ME LEKË", KEJVINA REAGON NË MËNYRË TË PAPRITUR NDAJ FANSIT • NUK NDALET LUANA VJOLLCA, SJELL BASHKËPUNIMIN E RADHËS
- ROBERT BERISHA URON NIPIN PËR DITËLINDJEN, POR S'ISHTE I PRANISHËM NË FESTË

## “Do përfundosh me qerosin me lekë”, Kejvina reagon në mënyrë të papritur ndaj fansit

Kejvina Kthella, ish-velina e “Xing me Ermalin”, që nga fama e marrë në emision është kthyer në një ndër femrat më të njohura e të komentuar të “showbiz”-it. Tani që është larg ekranit, ajo mban “lidhur” vëmendjen e fansave përmes rrjeteve sociale. Shpesh realizon miniintervista me ndjekësit, nga ku ka zbuluar disa sekrete për jetën e saj. Pyetja e radhës ka qenë se çfarë i trembte më tepër fansat e saj. “Që ti mund të përfundosh me ndonjë qeros me lekë dhe është gjynah se je gjithë ajo femër”, - i shkruan ndjekësi, të cilit Kejvina ia ka kthyer: “Por vetëm në qoftë se do jetë Mastro Lindo”, duke bashkëngjitur krahas postimit edhe foton e tij.





## Nuk ndalet Luana Vjollca, sjell bashkëpunimin e radhës

Edhe pse gjatë kësaj periudhe është larg ekranit, Luana Vjollca i është përkushtuar me pasion muzikës, duke punuar në studio për këngën e saj të radhës. Me anë të një fotoje në “Instagram”, Luana ka treguar ‘look’-un me të cilin do ta shohim në videoklip, duke u shfaqur e veshur me të bardha dhe si gjithnjë në super formë. Këngëtarja ka zbuluar se do vijë me një bashkëpunim, mirëpo i ka çmendur fansat duke mos e zbuluar emrin. Menjëherë kanë nisur aludimet e shumta se me cilin këngëtar do e sjellë këngën e re Luana, por gjithçka pritet të zbulohet nga vetë këngëtarja.

## Largohet nga televizioni Albana Osmani, ja ku do ta shohim së shpejti

Prej kohësh ajo e kishte menduar të merrte këtë hap. Moderatorja e njohur e “Top Channel” ka vendosur të largohet nga ky televizioni për t’i dhënë jetë një projekti të ri që mban firmën e saj. Albana Osmani, prezantuesen simpatike, të cilën e kemi parë shpeshherë në drejtimin e formateve të rëndësishme në “Top Channel” e disa herë si opinioniste në “Top Show”, me sa duket nuk do e shohim më në ekran, pas vendimit që ajo ka ndërmarrë për t’ju përkushtuar totalisht një sipërmarrjeje të re. Nuk është organizata jofitimprurëse “You are a sunflower”, të cilën Albana vijon ta ketë një nga angazhimet parësore profesionale të saj, e cila po njeh zgjerim në të gjitha trojet shqiptare, në Shqipëri, Kosovë, etj. Këtë herë bëhet fjalë për radion, një nga dashuritë e para të Albanës. Sipas burimeve të një media ‘online’, ajo ka vendosur të krijojë një radio të re, dhe do të njihet si “O1Radio”. Të shohim ç’gjë të bukur do të sjellë ky projekt i ri i Albanës.



## Dafina Zeqiri s’flet më me Noizyn dhe Dhurata Dorën, shkak bashkëpunimi i tyre?

Edhe pse më parë, por nuk i dhëmë rëndësinë e duhur. Por pas Noizyt, radhën e paska këngëtarja e hitit “Zemër”, Dhurata Dora. Tashmë këngëtarja Dafina Zeqiri i ka hequr të dy nga “Instagram”-i i saj. Dafi dhe Dhurata nuk e ndjekin më njëra-tjetrën, po kështu edhe Noizy me Dafinën, të cilët më parë sollën edhe një bashkëpunim, “A don love?”. Mbase kjo, sepse në llogarinë e menaxherit të Dhuratës së fundmi u postua se do të ketë një bashkëpunim me Noizyn. Mbase kjo është arsyeja apo edhe më thellë se kaq.

## Robert Berisha uron nipin për ditëlindjen, por s'ishte i pranishëm në festë

Ditën e enjte, vogëlushi Tian ka festuar ditëlindjen e tij të dytë në një organizimin shumë privat dhe të bukur nga prindërit e tij. Këtë vit, festa është ndërtuar në një fermë dhe të gjithë detajet e saj i sillnin të pranishmit më afër natyrës. Tian u shfaq shumë i emocionuar në fotot e ndryshme të setit fotografik, që publikuan Tuna dhe Patris. Urimet nuk munguan nga fansat e të dy personazheve të njohur, por edhe nga kolegë dhe miq të çiftit. Sigurisht në një ditë kaq speciale për të voglin nuk mund të mungonte urimi i Robertit, xhaxhait të tij. Në një foto ku shfaqet vëllai i tij, Patris me Renee dhe Tian, këngëtarë i njohur i uron nipit: "Gëzuar ditëlindjen". Siç edhe kuptohet, kjo foto tregon se marrëdhëniet e tij me Tunën vazhdojnë të jenë ende jo të mira. Madje, duket qartë që askush nga familja e Robertit nuk ka qenë i pranishëm në festën e 2-vjetorit të Tian.




## Ronela Hajati i jep fund "telenovelës" me Young Zerkën: Nuk është i imi!

Tashmë prej kohësh, marrëdhënia mes Ronela Hajatit dhe Young Zerkës është shndërruar në një telenovelë. Por mesa duket, vetë protagonistja, e lodhur nga ky rol ka dashur të shprehet lidhur me këtë çështje. Ajo ishte e ftuar dje në programin "Trokit" në "IN TV". Moderatorit i vendosi këngëtares në ekran deklaratën ekskluzive të Zerkës po në programin "Trokit" dhe Ronela shtoi: "Të jetë për mua, nuk flitet fare. Ne jemi mësuar që themi nëpër intervista jeta është e shenjtë apo... 's'kemi asnjëri". Tani... të lutem, nuk ka shanse të thuash nuk jam me asnjëri apo nuk kam gjë".  
 Ermali: Thuaje troç 'i imi është dhe kjo punë ka marrë fund!  
 Ronela: Po nuk është i mi!  
 Ermali: Ja filloi tani saga.  
 Ronela: Kam kohë unë për ato punë...!  
 Ermali: E konludojmë me një foto tuajën me puthje!  
 Ronela: Po, llapën shtizë deri në mushkëri!  
 Më tej, moderatorit tha se dyshja nuk është më bashkë dhe Ronela nuk kundërshtoi aspak! Dhe "telenovela" vazhdon...

## "Personazhe televizive të shtirur"! Adrola Dushi duket e revoltuar, por me kë e ka?

Bukuroshja e njohur, Adrola Dushi, ka bërë së fundmi një deklaratë të fortë në "Instagram". Modelja shqiptare flet për falsitetin e programeve televizive dhe personazhet e shtirur, pa përmendur asnjë konkretisht. Adrola madje shkruan se ky falsitet ka arritur deri te komshinjtë që i buzëqeshin njëri-tjetrit të sforcuar. "E mbyti falsiteti këtë vend, që nga programet televizive, personazhet e saj super të shtirur e deri te komshinjtë, që sforcuar buzëqeshin njëri-tjetrin", shkruan Adrola. Më tej ajo sjell ndërmend një skeç të të madhit Paulin Preka, i cili është shprehur konkretisht: "Një Zot e di sa herë më vjen ndërmend humori i të madhit Paulin Preka, i cili në një skeç thoshte: 'Ne jemi mësuar të qeshim fals, të duhemi fals, të marthohemi fals, ende edhe të bëjmë fëmijë fals', shkruan më tej modelja. Ende nuk dihet me kë e ka konkretisht këtë postim, por duket që dikush apo disa ia kanë sjellë në majtë të hundës me falsitetin e tyre.



## Dalin sondazhet para Eurovisionit, Jonida Maliqi renditet në vendin e dytë

Tashmë na kanë mbetur vetëm dy javë deri te nisja e festivalit evropian të muzikës, i njohur si Eurovisioni. Uebfaqja që merret me këtë festival prestigjioz, "Wiwibloggs" ka bërë një sondazh me këngët pjesëmarrëse. Pas numërimit të 42632 votave për 41 këngët pjesëmarrëse, përfaqësuesi i Holandës, Duncan Laurence, i cili do të këndojë këngën, "Arcade" mori 5036 vota, që është 11.81 për qind e të gjitha votave të hedhura. Njëherazi është 1.500 vota më shumë se rivali i tij më i afërt, ku gjendet përfaqësuesja shqiptare. Në vendin e dytë është renditur Jonida Maliqi e Shqipërisë. Këngëtarja e këngës, "Ktheju Tokës" ka fituar 3484 vota ose 8.17 për qind të votave të hedhura. Në dhjetor, Shqipëria u bë vendi i parë që zgjodhi këngëtares dhe këngën e saj për Tel Avivin. Dhe ngadalë, por me siguri Jonida është duke fituar vull që nga ajo kohë. Edicioni i 64-të i festivalit do të mbahet në Izrael nga data 14 deri më 18 maj në qytetin e Tel Avivit.

*“Një nga objektivat tanë, ta bëjmë Italinë të njohë muzikën dhe kulturën e të mrekullohet me të”*



Flasin binjaket shqiptare: Produksioni italian, i emocionuar që sillnim kulturën tonë në skenë

**EKSKLUZIVE**

Pamela Aliaj

# Pjesë e “Voice of Italy”, rrëfehen Serena dhe Ina Sinani: Emocionet e para dhe sfida për të kënduar shqip

**P**ak net më parë ato morën pjesë për herë të parë përpara një jurie italiane në një nga formatet më të njohura në vend, “The Voice of Italy”. Habia dhe ajo që i mrekulloi të katërt anëtarët ishte fakti se dy vajzat kënduan këngën e Era Istrefit dhe Ledri Vulës, “Shumë pis” në një performancë të tyren unike. Këto emocione e shumë detaje të tjera binjaket Serena dhe Ina na i kanë rrëfyer për herë të parë në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”.

“Akoma nuk na besohet që u kthyen të katërt gjyqtarët. Për ne është që tani një arritje shumë e madhe. Nga ana tjetër, ‘The Voice’ është programi i parë në të cilin marrim pjesë dhe për ne është një eksperiencë e re dhe shumë e bukur”, janë shprehur ato.

**Por, si nisi gjithçka dhe duhet theksuar se ato s’janë vetëm këngëtare, por edhe kompozitore e tekstshkruese. Nga nisi gjithë ky frymëzim e talent?**

“Kemi qenë gjithmonë të apasionuara pas muzikës. Që të vogla na pëlqente shumë të këndonim dhe e bënim kudo. Përpara se të këndonim seriozisht së bashku, kemi mësuar të luajmë në kitarë dhe kemi marrë për një vit leksione kantoje, por pjesën më të madhe të kohës kemi mesuar autodidact (vetë)”, kanë thënë ato.

Për t’i njohur akoma më mirë binjaket Sinani ndiqni intervistën e mëposhtme, ku do të zbuloni akoma më shumë surpriza, ndërkohë që Serena dhe Ina vijojnë ëndrrën në “The Voice of Italy”, duke na bërë akoma dhe më tepër kenarë!

“Sindolls” janë dy binjaket shqiptare që dalluan në “The Voice of Italy”. Pse pikërisht ky emër?



Kemi zgjedhur këtë emër, sepse donim të përdornim fjalën “kukull”, por të anulonim konceptin e saj të perfeksionit. Kështu që i shtuam ‘Sin’ (mëkat në anglisht), për t’i dhënë konceptin e mëkatit si dhe tre shkronjat e para të mbiemrit tonë, Sinani.

**Si ishte eksperiencia juaj në “The Voice” dhe si e pritët pëlqimin e menjëhershëm nga juria?**

Akoma nuk na besohet që u kthyen të katërt gjyqtarët. Për ne është që tani një arritje shumë e madhe. Nga ana tjetër, “The Voice” është programi i parë në të cilin marrim pjesë dhe për ne është një eksperiencë e re dhe shumë e bukur.

**Kenë thënë që do të këndonit në shqip edhe në netët në vijim. I qëndroni kësaj deklaratë të bërë pas natës së parë të pranimit në “Voice of Italy”?**

Po, një nga objektivat tanë është ai që ta bëjmë Italinë të njohë muzikën dhe kulturën shqiptare, sepse përfaqëson origjinën tonë dhe do të ishte shumë bukur që sa më

shumë persona të zbulojnë sa e mrekullueshme është.

**Si vendosët të merrnit pjesë në “Voice of Italy”? Kush ju nxiti, e kujt ishte ideja?**

Kemi vendosur të futemi në këtë eksperiencë për të pasur një mundësi për t’u njohur nga një publik më i madh dhe të kalojmë nga koverat e bërë në “Youtube” në dhomë, në eksperiencën tonë të parë televizive. Fillimisht ishim në mëdyshje, por kur zbuluan se një nga trajnerët do ishte Guè Pequeno, nuk patëm më dyshime.

**Prej sa vitesh jeni në Itali Si është historia e familjes suaj?**

Prindërit tanë janë shqiptarë dhe janë transferuar këtu në Itali përpara se ne të lindim. Por mendohejmë të kthehemi në shtëpinë tonë në Shqipëri çdo verë, sepse na pëlqen shumë dhe jemi shumë të lidhura me tokën e origjinës.

**Çfarë sakrificash kanë bërë prindërit tuaj për të qenë pjesë e komunitetit**







**italian?**

Nuk ishte e lehtë për ta të nisnin nga zero duke qenë se ishin të huaj, sidomos të bënin që të pranoheshin dhe të respektoheshin nga komuniteti. Por, avash-avash, duke punuar në mënyrë të ndershme dhe duke u njohur për atë që janë kanë fituar respektin që meritojnë dhe jetojnë shumë mirë.

**Si lindi pasioni për muz-**

prezantimin e fshehtë (blind).

**Jeni binjake shumë të veçanta në stilin dhe muzikalitetin tuaj. Por, a janë njësoj Ina dhe Serena jashtë kamerës? Nga dalloni nga njëra-tjetra?**

Në nivelin e imazhit dhe të muzikës jemi shumë të njëjta, por edhe pse jemi binjake, nga karakteret jemi shumë të ndryshme. Logjikojmë shpesh në mënyrë të ndry-

**pasione dhe preferenca për të ardhmen?**

Ndajmë të dyja të njëjtin pasion dhe në lidhje me të ardhmen jemi dakord mbi atë që duam të arrijmë: do të na pëlqente të publikonim punime tonat dhe të përfshijmë një publik më të gjerë dëgjuesish që na vlerësojnë për zhanrin që bëjmë.

**Kush është më guximtarja dhe kush më çap-**

shpejt me personat që më bëjnë të ndihem vetvetja dhe mundohem të bëj të njëjtën gjë me ta. Ndërkohë që Ina nuk e ka aspak problem dhe mundohet të flasë me të gjithë edhe pa i njohur mirë.

**Ju keni një pasion shumë të madh për muzikën, e cila s'ka lidhje vetëm me të kënduarit. Ju edhe kompozoni e i shkruani këngët. Si e realizoni**

dosur modifikimet e duhura. **Kush ju ka frymëzuar për këtë stil muzike dhe a është dikush në familjen tuaj që ka një talent të tillë nga i cili e keni trashëguar?**

Babi është artist, bën skulptura dhe vizaton shumë mirë, ndërkohë që mami dashuron muzikën dhe kur ka qenë e re ka dashur shumë të këndon-te. Ata kanë ndikuar shumë në këtë aspekt. Gjithashtu jemi rritur duke dëgjuar R&B, Hip Hop dhe shumë zhanre të tjera që të vogla dhe lindi tek ne një pasion shumë i madh për muzikën dhe dëgjojmë çdo gjë.

**Cili është sipas jush "kali i luftës" me të cilin mendoni se mund të rrëmbeni fitoren?**

Për ne, "kali ynë i luftës" mund të jetë një pjesë muzikore që mikson të gjitha kapacitetet tona për të kënduar,



**ikën? Sa kohë keni që merreni me muzikë?**

Kemi qenë gjithmonë të apasionuara pas muzikës. Që të vogla na pëlqente shumë të këndonim dhe e bënim kudo. Përpara se të këndonim seriozisht së bashku, kemi mësuar të luajmë në kitarë dhe kemi marrë për një vit leksione kantoje, por pjesën më të madhe të kohës kemi mësuar autodidakt.

**Pse menduat të shkoni dyshe në konkurs? Nuk mendoni se mund t'ju penalizojë sadopak kjo gjë?**

Për ne të qenurit dy nuk është një pikë e dobët, por e fortë. Mund t'i bëjmë të mira këngët, të krijojmë harmonizime dhe ta bëjmë më të plotë harmoninë e teksteve.

**A keni hasur vështirësi në konkurs apo edhe jashtë tij duke qenë se jeni shqiptare?**

Fakti i të qenurit shqiptare nuk ka ndërhyrë asnjëherë me rrugëtimin tonë muzikor, përkundrazi vetë producentët e programit ishin të lumtur që sillnim kulturën tonë në këngën që u propozuam në

shme nga njëra-tjetra dhe kemi shije të ndryshme si psh., në ushqim e sidomos tek djemtë. Miqtë dhe të afërmit na dallojnë nga zëri, sytë dhe sidomos nga mënyrat e të shprehurit.

**Keni të dyja të njëjtat**

**kënia? Nga ju dallojnë njërezit përveçse nga veshja?**

Jemi të dyja shumë guximtare dhe besoj se është vënë re, gjithashtu jemi të dyja shumë të gjalla si tipa. Unë (Serena), hapem shumë

**këtë gjë, bashke apo i keni të ndara si procese?**

Kur shkruajmë diçka, vendosim një ide të përbashkët dhe pastaj secila shkruan të vetën, pjesën e saj. Në vijim i vendosim të gjitha së bashku dhe përballemi për të ven-

diçka si në prezantimin e fshehtë (blind).

Së fundmi, për t'ju njohur më mirë. Serena dhe Ina janë sa të njëjta edhe të ndryshme nga njëra-tjetra. Cila është pika më e fortë dhe më e dobët e secilës?

**Serena:** Pika e fortë e Inës është profesionalizmi në montimin e videove dhe të punojë fort për t'i nxjerrë sa më mirë regjistrimet tona. Pika e dobët është se bëhet shumë e vështirë kur nervozohet.

**Ina:** Pika e fortë e Serenës është se kur nis diçka, jep gjithmonë 100% për ta çuar në fund. Pika e saj e dobët është se sipas meje, ndonjëherë është shumë pesimiste.

**Cila është shprehja apo muza që motivon secilën në çdo ditë të jetës suaj?**

**Serena:** Ajo që më motivon është ambicia dhe dëshira për t'u bërë dikush në botën e muzikës, që e dua me gjithë zemër.

**Ina:** Frymëzimi im më i madh është arti në vetvete dhe nevoja për të ndarë idetë sipas krireteve të mija.



Nga Alban Skënderaj te Sabina Dana, talentet e reja që do u zënë vendin këngëtarëve të famshëm

# Në gjurmët e gjakut, vogëlushët që zgjodhën profesionin e prindërve VIP

*Talenti trashëgohet, ja cilët fëmijë e kanë pasur këtë fat*

Pamela Aliaj

Shpesh dëgjojmë disa shprehje si: "Bëmë baba të të ngjaj", apo edhe shumë të tjera dhe në fakt, të shohësh sesi gjenet trashëgohen, është një gjë vërtetë fantastike. Sidomos kur bëhet fjalë për gjene të talentuara si VIP-at tanë këngëtarë, të cilët zërin e tyre si dhuratë të lindur ua kanë kaluar edhe fëmijëve. Kush ende fëmijë e kush në një moshë më madhore kanë treguar mjaft mirë me zërin e tyre se talenti trashëgohet. Më poshtë ju listojmë disa nga fëmijët që kanë prindërit e famshëm, që shumë shpejt do të ndjekin apo kanë nisur të ndjekin rrugën e tyre.

## ELITA E ARIF ZIBERIT TË GRUPIT "ELITA 5"

Grupi i famshëm muzikor "Elita 5" mban në fakt emrin e saj. Vajza e Arif Ziberit ka trashëguar gjenin artistik të të atit dhe po e dëshmon më së miri çdo ditë këtë. Pas suksesit që Elita ka pasur me grupin e saj, ajo ka guxuar edhe më tej, sapo ka marrë pjesë në konkursin muzikor "The Voice of Turkey" duke bërë për vete të gjithë anëtarët e jurisë. Ata i kthyen karriget të befashuar nga talenti i saj. Kur e pyetën se nga vinte, ajo tregoi se vinte nga Tetova, por jo vetëm kaq. Elita ka kënduar edhe një fragment nga kënga shqiptare "Hapi sytë e zezë" duke konfirmuar kështu edhe njëherë veten si këngëtare. Arifi, solisti i famshëm i grupit "Elita 5", duket se është shumë i emocionuar dhe krenar nga rruga që po ndjek e bija. Në një status në "Facebook", ai i ka uruar asaj suksese dhe është shprehur se ndihet krenar me të dhe nuk është i vetmi. "Suksese Elita, krenohet babi me ty", - ka shkruar këngëtari, ndërkohë që Elitës i urojnë fat edhe shumë admirues të tjerë në rrjetet sociale.

## ERA E ERMAL FEJZULLAHUT

"Zemër" është hiti i momentit, kënduar nga Dhurata Dora dhe reperit algerian,



Soolking. Kënga është pritur mjaft mirë nga publiku, pasi ka arritur që të ketë më shumë se 14 milionë klikime në kanal "Youtube" brenda 4-ditëve. E mesa duket, kënga pëlqehet shumë edhe nga

këngëtari i njohur, Ermal Fejzullahu dhe vajza e tij, Erës. Ai ka publikuar në profilin e tij në "Instagram" një video teksa këndon dhe nget njëkohësisht makinën. Ermali shfaqet së bashku me të bijën teksa

këndojnë "Zemër", ndërkohë bashkëngjitur me videon ai shkruan: "Zemër me zemrën time". E mesa duket, vajza e Ermalit do të trashëgojë në të ardhmen talentin e babait dhe gjyshit të saj, Sabri Fejzullahu.

## TARA E TEUTA SELIMIT DHE BLERO MUHARREMIT

Tara është në përgatitje të albumit të saj të parë. Të paktën kështu ka bërë të ditur këngëtari Blero, i cili ka pos-





skenës prej një kohe të gjatë, u shpreh se nuk ishte ekkzak-tësishit dëshira e tij që e bija të merrej me muzikë. “Unë nuk doja që ajo të merrej me muzikë, sepse nuk është dhe aq e thjeshtë...”, – u shpreh Kolonja, megjithatë më tej pohoi se përfundimisht i kish-te lënë rrugë të lirë të bijës që të ndiqte ëndrrën e saj.

**AMELI E ALBAN SKËNDERAJT DHE MIRIAM CAMIT**

Miriam Cani dhe Alban Skënderaj kanë një marrëdhënie shumë të ngushtë me vajzën e tyre, Amelin. Ata publikojnë shpeshherë foto në “Instagram”, shkëputur nga momentet që kalojnë bashkë si familje, apo nga momentet kur Ameli luan muzikë në piano. Ndër to vëmë re një video të publikuar nga Miriami ku dëgjohet zëri i ëmbël i vogëlushes, e cila i këndon mamit një ninullë. “Erdhi dita të më vërë Ameli mua në gjumë”, ka shkruar Miriami. Mesa duket, më rritjen e Amelisë, edhe lidhja e tyre sa vjen dhe përforcohet më shumë. Me dy prindër të talentuar si Miriami dhe Albani dhe me një zë si të Amelisë, me siguri në të ardhmen do ta shohim të ndjekë edhe vogëlushja rrugën e muzikës.

**BORA E ORGESA ZAIMIT**

Orgesa Zaimi është një nga këngëtarët më të njohura shqiptare, e cila prej vitesh ka kënaqur publikun shqiptar me zërin e saj. Mirëpo duket se talentin dhe pasionin e saj do ta trashëgojë edhe bija, Bora, e cila është vetëm 6 vjeçe. Vetë Orgesa e ka zbuluar talentin e së bijës përmes një postimi në “Instastory”. Bora ka shkruar një këngë dhe e ka lënë me porosi që mami Orgesa ta lexojë. “Kënga ime... Mami shiko tani” – ka shkruar vogëlushja sipër letrës, që në brendësi ka vargjet e këngës që ka krijuar. “Kënga e parë që ka shpikur Bora quhet ‘O Zot i madh’... Vetëm pusulla ka tërë shtëpia me çfarëdolloj krijimi që i shpik mendja asaj”, – shkruan këngëtarja në videon e publikuar. Nga ana tjetër, Orgesa ka treguar se edhe i biri është i prirur drejt artit, por ndryshe nga Bora, ai ka pasion pikturën.

**DAHLIN E SABINA DANËS**

Edhe pse me pauzë të gjatë në muzikë, Sabina Dana mbetet një nga këngëtarët më të dashura për publikun. Por mesa duket, edhe vajzës së saj, Dahlin i pëlqen muzika. Në një video të publikuar nga këngëtarja dëgjohet Dahlin, e cila këndon teksta luan me lodra. Edhe pse vetëm 3 vjeçe, bukuroshja Dahlin dëgjohet teksta këndon këngën hit “Mike”. Ka gjasa që disa vite më vonë emri i Sabinës do të zëvendësohet me emrin e vajzës së saj, që me siguri do e jetë po aq të talentuar sa mami.



tuar një fotografi të Tarës duke inçizuar në studio. Ndërsa ai ka shkruar se janë duke regjistruar albumin e saj të parë, e natyrisht që producent është vetë ai. Ndërkohë që nëna e saj, aktorja Teuta

Krasniqi ka treguar në disa intervista Tara ka dëshirë të merret me art dhe se do jetë zgjedhja e saj, nëse në të ardhmen do të merret me muzikë ose aktrim, apo me të dyja këto.

**MAISELA E SELAMI KOLONJËS**

Para tri muajsh u zhvilluan audicionet të fshehura në “The Voice Kids”, ku kanë konkurruar shumë fëmijë. Disa e kaluan këtë fazë e të

tjerë nuk arritën që të fitonin. Mes konkurrentëve ishte edhe vajza e këngëtarit shumë të dashur për publikun shqiptar, Selami Kolonja, Maisela. Gjatë një interviste në prapaskenë, artisti i cili i mungon

Opinion i Ditës

# Nervozizmi i Ramës dhe Thaçit, shprehje dështimi në Samitin e Berlinit

Nga Xhevat Mustafa

(vijon nga faqja 1)

... Angela Merkel dhe me presidentin e Francës, Emanuel Macron duhet t'i kenë rënë lehtësisht në sy se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ai i Kosovës Hashim Thaçi, kryeministri ynë, Edi Rama dhe ai i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, nuk mundën t'i fshihnin zhgënjimet, zemërimin dhe nervozizmin. Këto shpreheshin ndjeshëm dhe qartë në fytyrat dhe tonet e tyre dhe si rrjedhojë edhe më shumë e më gjërë në deklaratimet, komentet dhe intervistat e tyre për këtë samit. Ndosh-ta ne, shumica e qytetarëve shqiptarë kemi më shumë arsye e të drejtë të ndihemi të mërzitur dhe dëshpëruar jo nga zhgënjimet dhe dështimet personale dhe qeveritare të kryeministrit Edi Rama, të presidentit Hashim Thaçi e të kryeministrit Zoran Zaev, por për faktin se, në fund të fundit, humbësit më të shumtë dhe më të mëdhenj nga ky samit jemi pikërisht ne si shtetas të thjeshtë dhe jo "zotat" e politikës dhe të qeverive tona. Duke iu referuar faktit se organizatorët dhe drejtuesit e këtij samiti kishin përcaktuar katër çështje si prioritare për vendet e Ballkanit Perëndimor, saktësisht "siguria, luftimi i kontrabandës së armëve, terrorizmi, migracioni i pakontrolluar dhe kriminaliteti i organizuar", merret me mend se përse kryeqeveritarët dhe kryesh-tetarët tanë nuk morën përgjigjet që dëshironin nga Merkel dhe Macron personalisht dhe nga samiti dhe përjetuan zhgënjim dhe nervozizëm. Në të katër këto prioritetet qeveritë e tri vendeve tona, po ashtu si edhe ajo e Serbisë, nuk kishin nga të gjenin fije kashte për t'u kapur. Në të kundërt, ishin të zbuluara për varfëri arrijtjesh, suksesesh apo fitoresh konkrete. Për Merkel dhe Macron, domethënë edhe për Holandën dhe shumicën e vendeve të tjera të BE-së, janë deficitare apo "mbetëse në klasë" në përmirësimin dhe respektimin e detyrimeve "për qëndrim të paturdur pro demokracisë, ndaj shtetit ligjor; për vepra dhe akte të përgjegjshme dhe serioze shtetërore për luftimin e korrupsionit; për forcimin e rolit të shoqërisë civile dhe të mediave të pavarura". E megjithatë, edhe pse duhet të ishte i vetëdijshëm për "thesin thuajse bosh" mbi supe me të cilin po shkonte në samitin e Berlinit dhe i parapërgatitur për "dush me ujë të ftohtë" nga Merkel dhe Macron, përsëri kryeministri ynë, Edi Rama, nuk e fshehu bindjen e tij se "Shqipëria e meritonte hapjen e negociatave...". Ashtu siç pritej dhe e meritonte, Merkel dhe Macron, i dhanë përgjigjen e shumicës së pedagogëve për studentët mbetës në provimet e qershorit, "Kthehu në shtator"! Kjo lejon edhe



interpretimin "takohemi edhe një herë andej nga shtatori dhe shikojmë e bëjmë përsëri... si deri më sot e prej shumë vitesh!" Në nëntëstin e kësaj përgjigjeje negative mund të përfshihet edhe mesazhi, i shprehur apo jo hapur apo drejtpërdrejt nga Merkel dhe Macron kryeministrit tone dhe presidentit të Kosovës: "Kush nuk i merr seriozisht dhe nuk i respekton sa dhe si duhet shtetë demokratike e vërtetë, shtetin ligjor, pavarësinë nga politika dhe qeverisjet të institucioneve të drejtësisë, të mediave, të shoqërisë civile; kush nuk i zbut valët e emigrantëve, të refugjatëve, droggrave, armëve dhe të krimin të organizuar në drejtim të Gjermanisë, të Francës, etj., kush bën ortakëri me bosët e krimin dhe i përmbyt institucionet qeveritare me të inkriminuar..., nuk mund të jetë serioz, i besueshëm, i respektueshëm dhe i mbështetshëm edhe në politikën e jashtme e në procesin e integritimit...". E keqja jonë është se edhe në sezonin e shtatorit gjasat apo shanset për përgjigje pozitive për hapjen e negociatave me vendin tonë janë po kaq minimale, për të mos thënë të kota apo të pamundura, ndosh-ta jo vetëm për qershorin e ardhshëm, por edhe për disa qershorë të tjerë, deri aty nga ai i vitit 2025. Nënkuptohej se duke mos qenë aq trim sa t'i kundërshtonte "burrë-

isht apo shqiptarisht" Angela Merkelin dhe Emanuel Macronin sy më sy, kryeministri ynë, Edi Rama, e shfryu lëshimin e ndjesive negative nga Berlini mbi opozitën e vërtetë shqiptare, që e priste me protesta rrugëve si dhe mbi shumicën e mediave, që nuk i mbajnë iso ERTV-së së tij. Për të justifikuar sadopak përgjegjësinë e tij individuale dhe ekipore si dhe për të rimashtuar ata që "dëshirojnë akoma të lumturohen nga premtimet dhe mashtrimet e tij", Rama deklaroi se qenkemi "në paradhomën" e BE-së, por pa saktësuar dhe pranuar se jemi aty, duke pritur më shumë me sytë nga qielli, për të paktën, prej 6 vitesh... Zhgënjimi, dëshpërimi dhe zemërimi i kryeministrit tonë janë në doza edhe më të mëdha edhe për faktin se ai nuk u ndëshkua vetëm për dështimet personale dhe ekipore në frontin e brendshëm, por edhe për angazhimin dhe kontributin e tij në mbështetje apo "konsulencë" ndaj presidentit të Kosovës Hashim Thaçi dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, lidhur me idenë e vjetër serbo-ruse për korrigjimin e kufijve, në formë kompensimi, midis Kosovës dhe Serbisë. Sipas dokumentit të publikuar në përfundim të samitit të Berlinit, më 29 prill 2019, "Serbia dhe Kosova ranë dakord të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të realizuar marrëveshjet ekzistuese dhe

për t'u angazhuar konstruktivisht në dialogun e normalizimit të marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga BE, me synim për të arritur një marrëveshje përfundimtare gjithëpërfshirëse". Në dokument nuk përmenden as tarifat doganore ndaj Serbisë, e as propozimi për ndryshim kufijsh, arsye të forta për kryeministrin Ramush Haradinaj për t'u ndier më shumë fitues dhe i gëzuar se sa Hashim Thaçi dhe Edi Rama, me shumë gjasa nga përbrenda "helm e vrerë". Është shumë shprehës edhe fakti se në fillim të takimit Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emmanuel Macron ishin shprehur se "nuk donin të impononin një zgjidhje, por zgjidhja do të duhet të sillte stabilitet në të gjithë rajonin". Nga ana e saj Kancelarja Merkel u shpreh edhe më qartë: "Nuk mund të ketë marrëveshje, pasojat e të cilës mund t'i vuajnë vendet e tjera". Po sipas DW zhgënjyes, depresues apo stresues duhet të ketë qenë për Hashim Thaçin dhe Edi Ramën, por edhe për Ramush Haradinajin, edhe këmbëngulja e Francës për të mos liberalizuar regjimin e vizave ndaj Kosovës. Thaçi e shprehur këtë zhgënjim edhe para gazetarëve, duke e interpretuar si "diskriminim dhe ndëshkim për Kosovën". Sipas burimeve të DW nga pjesëmarrësit në takim, presidenti Macron e

kishte argumentuar mosmiratimin e heqjes së regjimit të vizave me përvojën e keqe të Francës pas liberalizimit të vizave me Shqipërinë dhe Gjeorgjinë, ku u sh-tua si numri i migrantëve të parregullt, ashtu edhe i kriminalitetit nga këto vende. Nisur nga fushata elektorale aktuale për zgjedhjet e parlamentit evropian, Macron kishte argumentuar se, nëse ai do të hiqte vizat edhe për Kosovën, kjo do të ishte në favor të partisë djathtiste të Frontit Nacional...". Pra, ndryshe nga sa tha në Tiranë, me gojën e vet dhe për veshët e anëtarëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, më 2 maj, për ERTV-në dhe media të tjera, që janë të futura hapur apo fshehurazi akoma nëpër xhepat e të shumtë të Edi Ramës, presidenti i Francës Emanuel Macron i është referuar hapur Shqipërisë, të këqijave dhe rreziqeve që i vijnë prej saj Francës dhe BE-së dhe kjo nuk është sajësë dashakeqe, antishqiptare, antiintegruese e "Saluti dhe dajë Titit, rrugëhumbërve dhe kadrinjve"... Duke e njohur mirë Edi Ramën, partinë dhe qeverinë e tij, duke e ditur se kanë afro 75 vjet që i mashtrojnë paturpësisht dhe pashpirtësisht shqiptarët, personalisht jam i prirur t'u besoj më shumë Angela Merkelit, Emanuel Macronit, "Deutsche Welle-s"... Përmbledhurazi, gjithnjë sipas këndvështrimit dhe gjykimit tim, Edi Rama dhe Hashim Thaçi u kthyen nga samiti i Berlinit si humbës, të përmbytur nga zhgënjimi dhe zemërimi. Por, ndosh-ta mund të ngushëllohen duke llogaritur si të mira e dobira, shtrëngimin e duarve dhe fotografitë e reja me Angela Merkelin dhe Emanuel Macronin si dhe përfaqsimin me njeri tjetrin, me Aleksandër Vuçiqin dhe, për herë të fundit, me mikeshën e tyre, Federika Mogherini, si shefe e politikës së jashtme e BE-së. Si shqiptarë, atyre u takon të ndjehen të gëzuar edhe për faktin se hapësirën e lënë nga SHBA-ja në Ballkan, me shumë gjasa, nuk do ta mbushë Rusia, por BE-ja, në radhë të parë, Gjermania dhe Franca. Ndërsa Ramush Haradinaj, u kthye si fitues dhe i gëzuar për çështje madhore, për të cilat nuk pati presion nga Merkel dhe Macron, por vetëm nga Hashim Thaçi e Edi Rama. Duke qenë dhe i fshehu se ai u kthye në Prishtinë edhe si njëri i mërzitur për mosmarrjen e një mesazhi dhe afati të qartë për liberalizimin e shpejtë të vizave për qytetarët e Kosovës... Por, në të vërtetë kjo nuk është humbje personale e tij si kryeministër dhe ekipore si qeveri. Më qartë e më shumë është "sukses personal" dhe përmblyllës i mandatit të Federika Mogherinit si shefe e politikës së jashtme të BE-së si dhe i Aleksandër Vuçiq-it. Ana Brnabiç-it, Ivica Dačić-it... të mbështetur nga larg e nga afër nga miq i madh dhe aleatit i tyre strategjik, Vladimir Putin...



TRAJNERI I LUGANOS



### Celestini: Sadiku si një luan, por nuk është më si më parë

Trajneri i Luganos, Fabio Celestini, merr në mbrojtje Armando Sadikun, duke larguar presionin e madh të tifozërisë bardhezi ndaj sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë. Sadiku, që u rik-

thyer te ekipi ku shkëlqeu në janar, ende nuk ka gjetur ritmin e së shkuarës së tij të afërt, ndërsa trajneri deklaron se pavarësisht përpjekjeve të tij të mëdha, sulmuesi kuqezi nuk është ai i dy sezoneve të

shkuara. "Mundohem gjithmonë që t'i jap qetësinë dhe t'i heq presionin. Nuk duhet të mendojmë se Sadiku i sotëm është i njëjtë me atë që luante përkrah Alioskit. Ai erdhi në Lugano pas një dëmtimi seri-

oz në gju, duhet t'i japim kohën e mjaftueshme. Ai është një luan, e dimë sforcon që ka bërë për t'u kthyer nga një operacion në ligament për një kohë kaq të shkurtër. Nuk jam i zhgënjyer nga rendimenti i tij. Ai na ndihmon në manovër me lëvizjet e tij, në zonë është gjithmonë i monitoruar dhe krijon hapësira për shokët", tha Celestini.

Tekniku bardheblu ndryshon objektivat në pak ditë, tashmë Kupa kalon në plan të dytë

Aradian Mema kërkon të mos zbalancohet më, ndonëse pak ditë më parë ia lejoi vetes diçka të tillë. Në konferencën e djeshme për shtyp, trajneri i Tiranës kërkon suksesin ndaj Skënderbeut për të arritur mbijetesën, pasi ky fund kampionati është vërtet i rrezikshëm për bardheblutë. Tekniku kryeqytetas kërkon fillimisht të shpëtojë sezonin, pastaj do të mendojë për kupën.

**NDESHJA E SË VËRTETËS**

"Pas ndeshjes në Gjirokastër jam më i qetë. Ekipi luajti mirë dhe është në moment të mirë. Ndosh-ta edhe lojtarët e kanë kuptuar se është momenti të shprehen më mirë se në të shkuarën, duke parë edhe klasifikimin që të detyron të përqendrohesh më shumë se zakonisht".

**PIKË E LËNA**

"Kemi lënë shumë pikë, nuk ndalem vetëm te ndeshja e fundit. Dy ndeshjet e radhës, Skënderbeu dhe Partizani, janë shumë vendimtare. Ikemi mundësitë t'i fitojmë këto ndeshje, pa problem. Megjithatë, duhet t'i marrim ndeshjet me radhë dhe kundër Skënderbeut është jetike".

**KONKURRENCA E EGËR**

"Është diçka shumë pozitive, që na ndihmon, sepse kështu asnjë ekipi nuk toleron dot. Kampionati është më i bukur, jam i sigurt që nuk ka hapësira për të lëshuar".

**KASTRIOTI**

"Është ende larg ajo përballje. Po fituam ndaj Skënderbeut, mendoj se Tirana do ta kalojë situatën jo të mirë që po përjeton. Janë edhe 15 pikë në lojë, kemi kohë për këtë ndeshje deri sa të vijë".

**NDESHJA PA TIFOZË**

"Na shkakton shumë keqardhje, sepse tifozët janë një plus i madh për ekipin. Gjithsesi, do bëjmë maksimumin. Mirë do ishte që të pranohet kërkesa e klubit për të paguar gjobë dhe të ktheheshin tifozët, por u refuzua".

**FORMACIONI**

"Nuk kemi asnjë mungesë. Do luajmë ata që me kanë pëlqyer më shumë në stërvitje".

**FINALJA E KUPËS**

"Së pari të shpëtojmë sezonin, pastaj shohim për kupën. Klubi do mbijetesën, pastaj finalen e kupës".

# Mema: Të shpëtojmë sezonin, pastaj mendojmë për Kupën!

Ndaj Skënderbeut duhet fitorja për mbijetesën



SUPERLIGA	
JAVA E 32-TË	
Të shtunën	
Flamurtari - Partizani	15:00
Tirana - Skënderbeu	15:00
Laçi - Kastrioti	15:00
Teuta - Luftëtari	15:00
Në tavolinë	
Kukësi - Kamza	3-0

### Zidan zgjedh portierin titullar te Real Madridi

Mediat spanjolle janë fokusuar ndjeshëm në këtë periudhë me atë që do të jetë Real Madridi i sezonit të ri. Natyrisht, që vëmendja u rrit edhe më pas rikthimit të Zinedin Zidan, francezit që fitoi 3 Champions League me "Los Blancos". Sipas të përditshmes "AS", ndryshe nga dy javë më parë, gjërat kanë ndryshuar në portën madrilene. "AS" saktëson se nuk do të jetë Tibo Kurtua portieri që do të largohet nga Reali, por Kejlor Navas, me belgun, që do të jetë titullari fiks i skuadërës kryeqytetase. Zinedin Zidan ia ka komunikuar vendimin e tij drejtuesve të "merengues", duke i hapur rrugën Navasit, me gardianin kosovarikan, i cili nuk ka pranuar të jetë më rezervë dhe mund të kalojë në Premier Ligë në verë.



### Ligji i ri, Italia gjen kleçkën për ta ringritur Serinë A

Antonio Conte, Pep Guardiola, Mauricio Pochettino janë vetëm tre nga emrat e top-trajnerëve në Europë gjatë muajve të fundit, dhe për një motiv apo për një tjetër, janë lakuar si kandidatë për stolin e skuadrave të Serinë A. Trajnerë me rrogë të frikshme! Për Konten, në garë flitet se janë Interi, Roma dhe Milani. Për gjenium katalanas flitet se do të zëvendësojnë Alergrin te Juventusin, ndërsa për argjentinasin e Tottenhamit është folur si kandidat i mundshëm për Milanin. Por pyetja e parë që të vjen ndërmend është edhe më legjitimja, cila skuadër mund t'ia lejojë vetes pagën e tyre? Përgjigje nuk ka. Mbase Juventusit, por edhe ky me një sakrificë të madhe financiare. Kjo të paktën deri në "Dekretin e Rritjes"



(Dekreti ligjor numër 34), i publikuar 30 prillin e shkuar në Fletoren Zyrtare. Shkurtimisht legjislacioni parashikon një taksim të lehtësuar për të "riatdhësuar-it", domethënë ata që, duke filluar nga 1 maji, do të transferohen në Itali dhe nuk kanë jetuar aty në dy vitet e fundit, do iu tatohet vetëm 30% e pagës për pesë vjet, me detyrimin e vetëm për të qëndruar në Itali të


paktën 24 muaj. Është e qartë se Guardiola, Pochettino dhe të gjithë teknikët e huaj do të përshatashin në kuadrin rregullator, por edhe Antonio Conte, i cili prej 2016-ës deri 2018-ës ka drejtuar Çelsin, por ende jeton në Londër. Ky ligji do të jetë në futboll edhe për lojtarët dhe do të jetë i përafërt me ligjin "Bekham", që lejon ringritjen e futbollit spanjoll në majë të Europës.

PËRFORCOHEN ZËRAT

### Juventus do Ikardin, Interi kënaqet me 80 mln euro

Mauro Ikardi është një emër që pëlqehet shumë nga drejtuesit e Juventusit, ky nuk është më një sekret. E provuan një sezon më parë e sigurt është se do ta provojnë sërish. Inter dhe Ikardi pritet të shkojnë drejt një divorci të sigurt në fund të sezonit, në këtë pikë në skenë del dhe një herë "Zonja e Vjetër". Sipas mediave italiane, Fabio Paratici, drejtori Sportiv i Juves dhe Pier Ausilio drejtori i Interit janë takuar në Londër për të ndjekur sfidën e Champions League, Tottenham-Ajaks, temë diskutimi ndërmjet tyre ka qenë dhe sulmuesi argjentinas. Nga pikëpamja ekonomike termat mbeten të njëjtë, Ikardi vlen 80 milionë euro ndërsa për bardheblutë jo më shumë se 60 milionë. Sipas "Corriere dello Sport", përcaktues në këtë traktative pritet të jetë Dibaba. Më sa duket asgjë nuk ka ndryshuar, emrat mbeten të njëjtë, shuma mbetet e njëjtë, pra ndërmjet dy klubeve ekziston një negociatë për të venë në jetë një lëvizje që pritet të trajtojë jo pak ambientin sportiv në Itali. Për këtë takim ndërmjet palëve nuk mund të flitet për asgjë të sigurt për sa kohë i pranishëm nuk ishte Bepe Marotta. Gjithashtu, një tjetër detaj që pritet të jetë përcaktues ka të bëjë me të ardhmen e Spallettit, nëse ai qëndron tek Interi, largimi i Ikardit është çështje kohe, diskutimi mund të ndryshojë në varësi të trajnerit të ri.

**Fjalëkryqi (1)**



37. Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.  
38. Ai dhe ajo.  
40. Një Madame e Maupassant.  
41. Kështu thirrej Ernesto Guevara.  
42. Fund ditari.  
43. Pije piratesh.  
45. Kush e thotë refuzon.  
46. Të parat në sondazh.  
47. Një makinë franceze.  
48. Fillojnë stafetën.  
49. Nisin nga fillimi.  
50. Qan te Turandot.  
51. Fundi i një samurai.  
52. Umberto qe shkroi Lavjeresi Foucault.  
53. Dalë në krye.
- VERTIKAL**  
1. Ajo e tretë u quajt Moskë.  
2. Në hyrje të odës.  
3. Me mea për të pënduarin.  
4. Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshima.  
5. Jepet për hartim.  
7. Lindi edhe Cerberin.  
8. Mbyllin pora.  
9. Gjysma e ekzit.  
10. Një inkursion me mig.  
12. Fillojnë lehtë.  
13. Eshhtë tretës me zorrë.  
14. Pak tematike.  
17. Qe mbreti jetëgjatë i Pilos.  
20. Eshhtë ndalim me pranga.  
22. Shkroi Këngëtarja tullace.  
23. Eshhtë pikë vaji.  
26. Ndajnë shtetet.  
28. Kush nuk ka... s'është njoftuar.  
32. Poetja e Lesbos.  
34. Kështu shprehet komisar Rex.  
36. Fillojnë panikun.  
38. Një liqen i kripur.  
39. Inva soprano.  
43. Inicialet e Altman  
44. Një fjalë për sipër.  
46. Të parat në stadium.  
47. Fillojnë turnin.  
48. Në hyrje të sokakut.  
49. Fillojnë nazet

**HORIZONTAL**

1. Steiger aktor.  
4. Mbetet në fund.  
6. Ustinov i kinemasë.  
11. Janë në modë.  
12. Nuk e shyen Danielin.  
15. Një as i Milan.  
16. Cobani aktore e jona.  
18. I dyti në kapitull.  
19. Dy asa në dorë.  
21. Qe njeriu i parë që u dënua padrejtësisht.  
23. Croft e Angelina Jolie.  
24. Një që mbahet për mondan.  
25. Para De Janeiro-s.  
27. Gjysmë tandem.  
29. Kap ndryshe.  
30. Gjysmë tatimi.  
31. Union Stutendor Operativ.  
33. Wallach aktor.  
35. Pak spjunazh.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


3. Një pune... paguhet.  
6. Para Zeppelin në grupin e famshëm.  
8. Vincenzo, bomber te Roma.  
12. Kufijtë e prijtes.  
13. Një Arthur i Edgar Allan Poe.  
16. Demek s'ka kufij.  
18. Qe filozofi i shkollës eleatike.  
19. Nino, kompozitor i famshëm italian.  
21. Eshhtë ai që ka ngrityr krye.  
23. Finlanda e... finlandezëve.  
25. Mbledh basketë separatistë.  
26. Inicialet e Prost.  
28. Shkroi Cockteyl party.  
29. Titulli i Alex ferguson.  
30. Stile pa kufij.  
32. Ishin greket që nuk vinin kurrë.  
35. Unë dhe ti.

**VERTIKAL**


36. Hoxha që qe arbitër.  
38. Eshhtë provë zjarr.  
39. Majtas në fund.  
41. Agjenci Ajrore Tiranë.  
42. Eshhtë partia e Ariel Sharon.  
43. Një mund të jetë çiklistik.  
45. Të parat në sondazh.  
46. E famshme ajo e psherëtimave.  
47. Qendër ditore.  
48. Një Baba përrallor.  
49. Mund të jetë proteste.  
50. Në fund të fundit.
- VERTIKAL**  
1. Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Cordonier.  
2. Në krye të solistëve.  
3. Janë poetë si Ungaretti.  
4. Ylli më i shndritshëm i Demit.  
5. Janë kopjet si delja Dolly.  
7. Një pjesë e dimensioneve.  
8. Fillojnë muzikën.  
9. Parafjala e prejardhjes.  
10. Fernando, bomber i Liverpool.  
11. Bisha aktore.  
12. Ishin ushtarë të Kserksit.  
14. Partia Demokratike.  
15. Cepat e një ylli.  
17. Ylli i baletit.  
20. Pak amoralitet.  
22. Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.  
24. Italia në Internet.  
27. Përhapet me frikë.  
31. Mund të jetë françeskan.  
33. Dehin pa kufij.  
34. Eshhtë lënda për... raftë.  
37. Gjysmë sahati.  
39. Tatum që qe pianist.  
40. Lloj papagalli.  
42. Një pikë vaji.  
44. Artikull spanjoll.  
45. Në krye të socialistëve.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		4		5	8		7	3
2		7						8
			6	2		7	5	
4	1			8	3			
	3		1		6		5	
			7	9			2	1
		5	3		1	4		
6						9		2
8	7		9	4		1		

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	2	4	9	6	8	5	7	3
7	3	9	1	2	5	4	6	8
5	6	8	3	4	7	9	1	2
4	7	2	5	9	3	1	8	6
6	5	3	8	1	4	2	9	7
8	9	1	2	7	6	3	4	5
2	8	7	4	3	9	6	5	1
9	1	5	6	8	2	7	3	4
3	4	6	7	5	1	8	2	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Ekzistenca e kaq shumë feve tregon mungesën e një perëndie të vërtetë brenda tyre.


- Dallimi i teorisë nga praktika, është shumë i vogël në teori, por shumë i madh në praktikë.

- Para se të kërkoni atë që u tha në lidhje me ju, mësoni se kush e ka thënë atë. E dita është më e

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



*Thënie të mençura*

- rëndësishme dhe përcakton vlerën dhe rëndësinë e të parës.
- - Gjithçka që fillon me siguri, përfundon me dyshim.
- \*- Nuk mund të jetë diçka domosdoshmërisht e drejtë sepse është ligjshme. Duhet të jetë e ligjshme, në qoftë se ajo është e drejtë
- - Ëndrrat janë si mrekullitë. Dalin të vërteta vetëm kur ju i besoni ato.

